

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**MËSIMDHËNIE E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE**

**NIVELI: MASTER**



**Tema: Master**

**Tema: Figura e gruas në letërsinë shqiptare**

Mentori:

Prof. asc.dr. Atdhe Hykolli

Studentja:

Bukurije Totaj

Prishtinë, 2021

© [2021]-[Bukurije Totaj] Të gjitha të drejtat të rezervuara

## **DEKLARATË ETIKE**

Me përgjegjësi të plotë zotohem se ky punim me titull “Figura e gruas në letërsinë shqipe”, i shkruar nga unë, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri apo ndonjë pjesë e veçantë e tij. Përveç rasteve të cituara dhe të referuara, ky punim nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër. Unë, Bukuriye Totakj, jap fjalën time se do të përdorë vetëm metoda etike dhe profesionale gjatë kryerjes së punimit tim, si studente e nivelit Master në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në kuadër të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Për hartimin e këtij punimi unë kam konsultuar literaturë relevante dhe kam pasur si synim që ky punim të kontribuojë pozitivisht në fushën e arsimit.

## MIRËNJOHJE

*Nga thellësia e zemrës do të doja të shprehja mirënjohjen e sinqertë për të gjithë ata që më kanë mbështetur dhe inkurajuar në realizimin e këtij studimi. Në radhë të parë, një falenderim i veçantë i takon mentorit tim Atdhe Hykolli , për punën e palodhshme, kujdesin dhe këshillat me vlerë gjatë punës sime studimore. Bashkëpunimi dhe etika e punës së tij nuk kanë qenë vetëm një frymëzim për mua, por edhe një model që ia vlen për t'u ndjekur.*

*Një falënderim shkon edhe për mësimdhënësit e shkollave fillore, pasi na dhanë mundësinë që ta realizojmë këtë punim si dhe qenë bashkëpunues në çdo moment. Po ashtu, shpreh mirënjohje për familjen dhe shoqërinë time të cilët në këtë rrugëtim qenë gjithmonë afër meje.*

*Së fundi, i falënderojmë edhe anëtarët e Komisionit Vlerësues të tezës, duke uruar që të jenë të kënaqur me punën që kemi bërë.*

## ABSTRAKT

### Figura e Gruas në Letërsinë Shqipe

Nga

Bukurije Totaj

Temën të cilën do ta trajtojmë në këtë punim është “Figura e gruas në letërsinë shqiptare”. Kundërthëniet rreth emancipimit të gruas që dikur ishin të pranishme në shoqëri, tashmë janë tejkaluar. Prapambeturitë e asaj kohe ishin si pasojë e ndikimit patriarkal e fisnor e që kishte ndikim edhe sundimi i huaj në vendin tonë. Prandaj problemi i emancipimit të gruas u paraqit si nevojë dhe ishte me rëndësi të studiohet edhe në letërsinë shqipe. Shumë autorë shqiptarë e kanë paraqitur në forma të ndryshme figurën e gruas, ajo shpesh gjendet në formën më të keqe patriarkale. Njëri ndër shkrimtarët tanë më të shquar, Sami Frashëri, na i sjell fjalët më të bukura për gruan: *"Gruaja është baza e shoqërisë njerëzore. Ajo është shtylla kryesore e moralit të përgjithshëm. Gruaja është nënë e fëmijës, zonjë e shtëpisë dhe e krejt njerëzisë."*

Ky hulumtim na sjell periudhat e lashta të popullit tonë duke vënë në pah virtytet e karakteristikat e femrës shqiptare, shëmbëlltyrën e saj të lartë që la në histori për t'u pasuar nga brezat e rinj.

Hulumtimi ynë do t'i analizojë disa personazhe si: Serafina Topia, Nita e romanit nga Rosip Rela, Sikur t'isha djalë nga Haki Stërmilli, Vita nga romani Lumi i Vdekur, Malësorja, Princesha Argjiro e Rozafati si dhe përgjithësisht kemi përmendur trajtimin nga ana e Migjenit për figurën e gruas. Edhe pse në strukturë nuk e përmbajnë të njëjtën pozitë, ky analizim do të na shpie në thelbin e përgjithshëm të kuptimit të figurës së gruas, në letërsinë shqipe. Historia jonë kombëtare gjatë shekujve të rëndë të robërisë është e mbushur përplot shembuj të heroizmit të femrës shqiptare. Roli dhe kontributi i saj në periudha të ndryshme historike për lirinë e atdheut është shumë i rëndësishëm, për të cilin ka se çka të shkruhet dhe të flitet. Prandaj, është fakt i pamohueshëm se femra shqiptare zë një vend të rëndësishëm në historinë kombëtare të popullit tonë, duke filluar që nga periudha ilire e më tej. Po ashtu ne kemi realizuar një pyetësor me 5 pyetje në lidhje me temën tonë, të cilën e kemi testuar me 10 mësimdhënës, në dy shkolla të mëdha të Komunës së Prishtinës.

*Fjalët kyqe: figurë, grua, letërsi, heroizëm*

## **ABSTRACT**

The Figure of Woman in Albanian Literature

from

Bukurije Totaj

The topic addressed in this paper is "The figure of women in Albanian literature." Controversies about the emancipation of women that were once present in society have now been overcome. The backwardness of that time was due to the patriarchal, tribal influence, and foreign influence in our country. Therefore, the problem of women's emancipation was presented as a need and it was important to study in Albanian literature. Many Albanian authors have presented the figure of a woman in different forms, she is often found in the worst form - patriarchal.

One of the most prominent writers, Sami Frashëri, brings the most beautiful words about woman: "Woman is the basis of human society. She is the main pillar of general morality. Woman is the mother of the child, the lady of home and the whole humanity."

This research brings up the ancient periods of our people, highlighting the virtues and characteristics of the Albanian woman, her high image that she left in history to be followed by the younger generations. The research will analyze some characters such as: "Serafina Topia", "Nita" of the novel by Rosip Relaj, "Sikur t'isha djalë" by Haki Stërmilli, "Vita" from the novel "Lumi i Vdekur", "Malësorja", "Princesha Argjiro", "Rozafati", and in general the approach for the figure of the woman, by Migjeni, that have been mentioned. Even though they do not contain the same position in the structure, this analysis will lead to the general essence of meaning of the figure of woman in Albanian literature. Our national history during the difficult centuries of captivity is full of examples of Albanian female heroism. Its role and contribution in different historical periods for the freedom of the homeland is very important, for which there is enough to write and talk about. Therefore, it is an undeniable fact that Albanian women occupy an important place in the national history of our people, starting from the Illyrian period onwards.

There is also a questionnaire with 5 questions conducted related to our topic, which is tested with 10 teachers, in two large schools, in the Municipality of Prishtina.

Keywords: figure, woman, literature, heroism.

## Përmbajtja:

DEKLARATË ETIKE .....	3
MIRËNJOHJE.....	4
ABSTRAKT .....	5
ABSTRACT .....	6
HYRJE .....	9
KAPITULLI I .....	10
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	10
1.1 QASJA TEORIKE E HULUMTIMIT TË PROBLEMIT .....	10
1.2 IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT .....	13
1.3 QËLLIMET E HULUMTIMIT .....	13
1.4 HIPOTEZAT: .....	13
1.5 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	14
METODA E ANALIZËS TEORIKE .....	14
METODA PËRSHKRUESE.....	14
METODA KRAHASUESE (KOMPARATIVE) .....	14
MOSTRA.....	14
ANALIZA E TË DHËNAVE.....	14
1.6 REZULTATET E PRITSHME TË HULUMTIMIT .....	15
1.7 PERIUDHA KOHORE E REALIZIMIT TË PUNIMIT .....	15
KAPITULLI II .....	16
FIGURA E GRUAS BRENDA PERIUDHAVE TË LETËRSISË SHQIPE .....	16
2.1 NGA ZONA E “HESHTJES”, NË REALITETET E NDALUARA; POZITA SOCIALE E FEMRËS NË BOTËN SHQIPTARE TË VITEVE ‘30-TË. ....	17
2.2 NDRYSHIMI I GRUAS BURON NGA ARSIMI: SHKOLLIMI SI NGUSHTUES I PABARAZISË GJINORE... ..	25
KAPITULLI III.....	34
DISA NGA VEPRAT SHQIPTARE KU TRAJTOHET FIGURA E GRUAS.....	34
3.1 LEGJENDA E MUROSJES SË GRUAS – ROZAFATI .....	34
3.2 VITA, FEMËR REVOLUCIONARE NË ROMANIN LUMI I VDEKUR .....	36
3.3 SERAFINA TOPIA - PASQYRË E PATRIOTIZMIT .....	40
3.4 MALËSORJA – VIKTIMË E TRADITAVE SHQIPTARE.....	42
3.5 PERSONAZHI I DIJES NË ROMANIN “SIKUR T’ISHA DJALË” – PATRIARKALITETI NDIKIM NEGATIV NË POZITËN E GRUAS.....	47
3.5.1 POZITA E GRUAS SHQIPTARE .....	49
3.5.2 MARTESA PËRBALLË TRADITËS .....	51
3.5.3. TENDENCA PËR TË THYER KODET E TRADITËS.....	52
3.6 PRINCESHA ARGJIRO – HEROINË SHQIPTARE .....	54

3.7 NITA – PËRJETIMI I METAMORFOZËS (SHNDËRRIMI NË MASHKULL I NITËS) .....	56
3.8 "EMIRA" E ANTON SANTORIT - DRAMA E PARË NË GJUHËN SHQIPE.....	57
3.9 DASHURIA E ANITËS NË KOHË LUFTE NË ROMANIN HASTA LA VISTA.....	58
3.10 FIGURA E FEMRËS SIPAS MIGJENIT DHE KRAHASIMI I PËRDORIMIT TË KËSAJ FIGURE ME BAUDELAIRE .....	59
3.9.1 AROMA.....	67
3.9.2 VALLËZIMI .....	69
3.9.3 DETI .....	71
3.9.4 VJESHTA, ERRËSIRA .....	72
KAPITULLI IV.....	75
ANALIZA E REZULTATEVE.....	75
5.1 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....	78
5.2 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	79
5.3 SHTOJCA .....	81
BIBLIOGRAFIA .....	82

*Tabela e Diagrameve:*

<i>Diagrami 1. Pozita e gruas në letërsinë shqiptare .....</i>	<i>75</i>
<i>Diagrami 2. Libri që e përfaqëson më së shumti patriarkalitetin në letërsinë shqipe.....</i>	<i>76</i>
<i>Diagrami 3. Dallimet e letërsisë së sotme me letërsinë e vjetër shqiptare.....</i>	<i>76</i>
<i>Diagrami 4. Rekomandimi i librave nga mësimdhënësit .....</i>	<i>77</i>
<i>Diagrami 5. Lëvizja feministe për tejkalim të patriarkalitetit .....</i>	<i>77</i>



## HYRJJE

Letërsia bashkëkohore shqiptare kaloi nëpër shtigje tepër të vështira duke u detyruar të kufizohet brenda uniformës së ngushtë të metodës së realizmit socialist. Në fillimin e viteve '60 do bëhen hapat e parë për të nxjerrë letërsinë nga ky shabllon. Me qëllim që të bëhet më i qartë vendi i gruas në shoqëri, në këtë punim masteri do të shtjellohen me shumë kujdes ide dhe mendime të autorëve shqiptarë, si dhe rreth marrëdhënieve mes grave dhe burrave duke dhënë shembuj të ndryshëm nga veprat letrare të asaj periudhe. Pikërisht, ky punim synon të provojë se autorët që do të analizohen në këtë punim, mundohen të shpalosin ide se gruaja është e pabarabartë nga e kaluara historike deri në periudhën viktoriane, duke krijuar personazhe dhe karaktere femërore të imagjinuara por me bazë në të vërtetën reale e të hidhur të asaj kohe.

Roli i gruas në shoqëri dhe në familje ishte kryesisht i njëjtë pothuajse për të gjitha gratë. Ajo duhej të ishte, para së gjithash, një amvise e mirë. Ishte fare i vogël numri i grave të punësuar. Në të vërtetë, kjo varej nga përkatësia e saj klasore. Kështu, gruaja e shtresës së lartë ishte amvise dhe rrallë punonte jashtë shtëpisë. Ajo zakonisht kishte një rutinë të përditshme dhe të mërzitshme. Ndërkaq, kohën e lirë të saj, ajo e kalonte duke lexuar, duke pritur mysafirë dhe duke shkruar në vizita: shpeshherë e shoqëronte burrin në ceremoni apo festa, në koncert apo teatër, por nëse nuk ishte e martuar, shoqërohej nga shoqet. Ajo vishej me salltanet, sipas modës. Gruaja e shtresës së mesme shoqërore, jo vetëm që ishte amvise, po kishte edhe shërbëtore apo guvernante në shtëpinë e saj dhe ndihej më e privilegjuar se gratë e shtresës së ulët. Ideali i gruas së shtresës së mesme, para martesës, ishte që të gjente një bashkëshort të pasur. Mirëpo, gruaja e shtresës së ulët shoqërore, ishte e privuar nga të gjitha të drejtat. Ajo nuk trajtohej njësoj si gratë e shtresave të tjera. Ajo zakonisht punonte si shërbëtore, vishte tesha të përdorura dhe shpeshherë ushqej në familjen ku punonte. Në shtëpitë e të pasurve ajo punonte si pastruese, si dado, qepte petka, përkujdesej për të sëmurët dhe invalidët. Gruaja e kësaj shtrese punonte edhe nëpër restorante, bujtina, mejhane, hotele, uzina, punishte, etj.

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do të bëjmë krahasime të përmbajtjes së autorëve shqiptarëve dhe librave të ndryshme. Po ashtu do të jepen mendime kritike në lidhje me figurën e gruas.

# Kapitulli I

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

### 1.1 Qasja teorike e hulumtimit të problemit

#### Shqyrtimi i literaturës

Letërsia bashkëkohore shqiptare kaloi nëpër shtigje tepër të vështira duke u detyruar të kufizohet brenda uniformës së ngushtë të metodës së realizmit socialist. Në fillimin e viteve '60 do bëhen hapat e parë për të nxjerrë letërsinë nga ky shabllon. Këtu përmendim kontributin e çmuar të Petro Markos me romanin e tij të parë "Hasta la vista" që sjell një këndvështrim të ri në letërsinë e asaj periudhe. Figura qëndrore në këtë roman është shqiptari Gori Gjinleka, vullnetar shqiptar dhe spanjollja e re dhe e bukur, Anita Gonzales. Siç kuptohet nga fillimi i romanit këta dy shpejt bien në dashuri, segment ky që do të bëhet subjekt i veprës. Dashuria e tyre lind në shikim të parë, por bëhet shumë e fortë dhe e sinqertë. Ata kanë edhe përkatësi të njëjtë ideologjike. Fatkeqësisht, kjo dashuri ndërpritet me kthimin e Gorit në atdhe. Mundësia për t'u takuar mbetet e hapur, sepse në ndarje Gori i thotë Anitës përshëndetjen spanjolle "hasta la vista", që do të thotë mirupafshim.

Më pas, po Petro Marko, boton romanin "Qyteti i fundit", në të cilin trajton një temë nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, por, është shkruar nga një kënd i ri, që solli një frymë të re në letërsinë shqiptare. Tërë ngjarja e romanit shtrihet brenda disa ditëve të fundit të qëndrimit të robërve italianë, të cilët të grumbulluar në portin e Durrësit, prisnin anijet e kthimit për në atdhe. Gjatë pritjes njëjavëshe, në port ndodhin ngjarje të ndryshme, jo të mëdha. Autori do të sjellë rrëfimin për dashurinë e oficerit të ri shqiptar Lekës dhe prostitutës së bukur italiane Ana Maria Monte, viktimë po ashtu e luftës dhe e fashizmit. Brenda 7 ditëve, aq sa qëndrojnë italianët e mbledhur në portin e Durrësit për t'u kthyer në Itali, shkrimtari në romanin "Qyteti i fundit" do të zbulojë dhe do të rrëfejë historitë dhe fatet e disave nga ushtria fashiste që para 4-5 viteve e kishte pushtuar Shqipërinë. Në këtë pleksje historish e fatesh, autori do të sajtojë linjën e rrëfimit që ndjek hetimi për zbulimin e një krimineli lufte, të maskuar dhe të fshehur brenda turmës së "Qytetit". Në krye të grupit që duhet ta organizojë dhe ta udhëheqë këtë zbulim është toger Leka. Pista që ndjek

togeri në këtë drejtim, e ngjashme me labirintet e romaneve deduktive, do të ecë dhe përmes prostitutës italiane - Ana Maria Monte. Dhe do të lindë dashuria mes tyre, që është shumëfish më "mëkatore" se ajo mes Gorit dhe Anitës. Leka është togër i Sigurimit Shtetëror të Shqipërisë së sapodalë nga lufta, që la pas shkatërrime dhe krime, ndërsa italianja Ana është e palës që i kreu ato krime, e palës së cilës i shërbente.

Kështu shkrimtari, duke ndjekur këtë linjë do të ecë nëpër një teh të mprehtë: do ta lejojë togërin e Sigurimit t'i nënshtrohet zërit të brendshëm dhe të dashurohet me italianen e bukur, apo do të nxjerrë para tij fuqinë e përgjegjësisë dhe të mëkatit ndaj "mollës së ndaluar"? Ndërkaq me personazhin femër, shenja më e qartë e pranisë së humanitetit dhe rrezëllitjes së pranisë së qenies njerëzore, P. Marko theu disa tabu të kohës, jo vetëm se femra ishte e huaj, jo vetëm se dashuria jepet si ndjenjë aq universale, sa mund të lidhë edhe dy njerëz të kombësive të ndryshme, por edhe për faktin e thjeshtë se femra në tekstet romanore të tij zuri një vend të merituar, qoftë dhe kur ajo ishte prostitutë. Shkrimtari është në anën e saj dhe e mbron, e adhuron guximin e saj, por është po kaq fuqishëm edhe me feminitetin dhe bukurinë që bart. Prania e luftës dhe e dashurisë, e rrokshme përgjithësisht në romanet e autorit, diçka më e thellë si përjetim etik dhe estetik, na shqiptohet në këto romane, shoqëruar ndërkaq edhe me një tis dëshpërimi dhe trishtimi rrezëllitës, të krijojnë bindjen e thellë se këto romane ia kanë mbërritur të skicojnë në letrat shqipe tiparet letrare të brezit të humbur. Faqet më të fuqishme të prozës së Petro Markos reflektojnë triumfin e dashurisë dhe të humanizmit njerëzor. Pas tërë atij ferri nëpër të cilin kalon njeriu në rrëfimin e Petro Markos, ai arrin të mbetet i pamposhtur nga mizoritë e botës. Këtë bërthamë të brendshme e rrezatojnë personazhet nga romanet e tij, këtë shkëlqim biblik reflekton Petro Marko njeri dhe Petro Marko shkrimtar në tërë veprat e tij.

Anton Pashku, me romanin "Oh" ndihmoi shprishjen e konvencave tradicionale të ndërtimit të rrëfimit në prozën tregimtare dhe ndërtimin e figurshëm të realitetit përshkrimor. Rrëfimi i ngjarjeve strukturohet si dialog i Burrit-rrëfimitarit me bashkëbiseduesen "e pranishme". Njeriu i vetmuar, në dhomën e errët, është kredhur në mendime. Në dhomë është gruaja por ajo nuk merr pjesë në shqetësimin e tij.

Nazmi Rrahmani në romanin "Malësorja", kryepersonazh ka Hajrijen, e cila nuk është e tipit të formuar, të gatshëm, por formohet gjatë rrëfimit, i cili rrjedh sipas teknikës kronologjike, të ndërprerë dhe të ndërpleksur herë-herë. Formimi i Hajrijes ndiqet sipas linjës së brendshme të shpalimit, nga motivet, pretendimet, vizioni i saj i brendshëm, ajo gradualisht vetëdijësohet për

pozitën e vet të nënshtuar, për mundësitë e veta të kufizuara, por tërë atë ngarkesë e bart në heshtje dhe dhimbje të plotë. Autori nganjëherë e bën të zëshëm vajin e saj të brendshëm vetëm përmes monologjeve të saj, dhe më rrallë përmes ndonjë dialogu, ndërhyrjeje apo sqarimi të çastit.

Pikërisht përmes kësaj pjese të tekstit narrativ, autori arrin ta shpalosë botën e brendshme të Hajrijes nëpërmjet rrëfimit psikologjik. Ngjarja në këtë roman rrëfëhet në vetën e tretë dhe nga pozicioni i narratorit të gjithëditur, që nënkupton distancën e autorit, përkatësisht mundësinë e pozicionimit objektiv rrëfyes. Tërë bota e rrëfyer shikohet me sytë e Hajrijes: nga ky kënd sajohen mekanizmat e vlerave dhe vlerësimet, nga kjo perspektivë sajohen parimet morale, kanunore. Anësimi në favor të kryepersonazhit, bëhet i dukshëm sidomos në momente kur narratori nuk përmbahet dot nga ndërhyrjet e motive të llojit: "e mjera (Hajrija), e ngrata," etj. Princesha Argjiro është sundimtarja e qytetit të Gjirokastrës gjatë shekullit XIV, pas vdekjes së burrit. Princesha Argjiro lufton me turqit kur ata e rrethojnë kalanë e Gjirokastrës, mirëpo njeri nga truporët e tradhëton, ndaj ata arrijnë të futen në Kala. Për të mos rënë e gjallë në duart e turqve, u hodh nga kulla më e lartë e kalasë bashke me djalin e saj foshnjë dhe u copëtua mbi një shkëmb. Mirëpo foshnja sipas legjendës mbeti gjallë.

Në romanin Nita ngjarja hapet në Brisk , krahinë e Shkodrës ku Nita qe rrëmbyer nga njerëzit e pashës dhe Zefi me tre trima tjerë e shpëtuan . Nga kjo ndodhi , një pjesë e madhe e krahinës vendos te shperngulet për në Zadar , Dalmaci . Zefi mbeti në Brisk , nderkohe Nita i dha besën se do ta priste . Kaluan tre vite dhe Nita nuk po martohej ndërkohe qe po e kerkonin per nuse djemte me të mire . Nita para një situatë të tillë , kërkuan ta shpallin mashkull , qe të rrinte e qetë. Kerkesa e saj u pranua dhe nga Nita , dhe tanimë do ishte Tani i Prenk Vukës Një ditë në vend po mbaheshin gara vrapimi , në nderkohe u tregojne se paska ardhur dikush nga anët tona . Ishte Zefi , mezi se i kishte gjetur , në ndërkohe Tani ishte i pari , kur mbaroj gara , Zefi shkoi ta takonte djaloshin por atehere e pa se ishte Nita , të dy e njohen njëri-tjetrin dhe Nites i ra të fiket U kuptua se ato dy e dashuronin njeri-tjetrin , u mblodh keshilli i pleqëve dhe ato po e shpallin fajtores Nitën , i kishte gënjyer të gjithë . Njëri nga anëtarët u tha : ne jemi larguar nga vendi ynë dhe zakonet tona dhe në kete vend dhe ato do ndryshojne bashke me ne . Jemi si degët të larguara nga rrënja U dëgjua krisma e nje kobureje , Nita ishte e mbuluar me gjak , Zefi kur e pa armën e vet ia drejtoi vetes por e ndaloi Prenk Vuka dhe i tha tani do jetojmë të dy për Nitën. Legjenda e Rozafës është një legjendë e përcjellur brez pas brezi. Ajo është trashëguar dhe përshtatur më së

miri nga penda e prozatorit të njohur Mitrush Kuteli për të gjithë lexuesit në librin (Tregime të Moçme Shqiptare).

## **1.2 Identifikimi i problemit**

Punimi ynë do të bazohet në paraqitjen e figurës së gruas te librat e autorëve shqiptarë. Pikësynimi ynë është hulumtimi me anë të metodave të ndryshme duke arritur në një rezultat mbi analizimin e figurës së gruas dhe pasqyrimet negative të cilat janë paraqitur për figurën e gruas në letërsi gjatë epokave të ndryshme.

Ky hulumtim është i rëndësishëm sepse analizimi i figurës së gruas në fakt tregon edhe nivelin e intelegjencës së një vendi.

## **1.3 Qëllimet e hulumtimit**

1. Të analizohen personazhet e lartpërmendura.
2. Të specifikohet figura e gruas.
3. Të tregohet në mënyrë reale se si është paraqitur figura e gruas.
4. Të bëhet analizim i thellë i paraqitjes së figurës së gruas.
5. Të bëhet dallimi midis autorëve në paraqitjen e figurës së gruas.

## **1.4 Hipotezat:**

H1- Figura e gruas në letërsinë shiptare ka dominuar në kahje negative

H2- Ka dominuar patriarkalitet në figurën e gruas te letërsia shqiptare

## **1.5 Metodologjia e hulumtimit**

Për ta realizuar këtë punim do të përdorim metoda të ndryshme të cilat do të na mundësojnë të arrijmë rezultate dhe njohuri të reja, apo t'i korrigjojmë ato ekzistuese.

Me qëllim që rezultatet e hulumtimit tonë të jenë sa më të sakta dhe të qëndrueshme do t'i përfshijmë këto metoda.

### **Metoda e analizës teorike**

Metoda e analizës teorike është e domosdoshme për një këtë hulumtim. Pa të kjo problematikë nuk do të mund të trajtohej në nivelin e duhur sa i përket aspektit teorik. Ajo do të shfrytëzohet në pjesën teorike, në burime të shumta të teksteve, studimeve dhe dorëshkrimeve të tjera.

### **Metoda përshkruese**

Kjo metodë do të zbatohet gjatë analizimit të figurës së gruas në letërsinë shqiptare, ku nëpërmjet ecurisë përshkruese me modalitetet e saj si analizimi, krahasimi dhe gjeneralizimi do të spikasim veçantitë specifike, të cilat e karakterizojnë problematikën që e kemi për objekt të studimit.

### **Metoda krahasuese (komparative)**

Metoda krahasuese do të përdoret për konstatimin e ngjajshmërive dhe ndryshimeve në mes të dukurive të ndryshme. Kjo metodë paraqet procedurë të krahasimit të autorëve duke treguar se si e kanë përceptuar dhe e kanë reflektuar figurën e gruas në letërsinë shqipe.

### **Mostra**

Si mostër për punimin e kësaj teme do t'i kemi disa libra të autorëve shqiptarë.

### **Analiza e të dhënave**

Në fund të gjitha të dhënat do të mblidhen dhe të analizohen për t'u paraqitur statistikisht.

## **1.6 Rezultatet e pritshme të hulumtimit**

Përmes këtij punimi do të vihet në pah se sa është vlerësuar figura e gruas në letërsinë shqiptare dhe do të tregohet se a ka pasur kjo figurë ngjyrim pozitiv apo negativ. Punimi do të arrij të shpjegoj shumë dukuri të cilat janë mjaft interesante dhe të cilat kanë qenë të paraqitura më herët në letërsinë shqiptare. Do të bëhet analizimi i autorëve dhe do të krahasohen mendimet e tyre në lidhje me temën e lartpërmendur

- ❖ Identifikimi i patriarkalitetit dhe ndikimi i tij në figurën e gruas.
- ❖ Identifikimi i personazheve dhe krahasimi i tyre me realitetin e ditëve të sotme.
- ❖ Rëndësia e figurës së gruas dhe pasqyrimi i saj negativ nga autorët e letërsisë shqiptare.

## **1.7 Periudha kohore e realizimit të punimit**

Punimi është paraparë të ndahet në tri periudha kohore:

Në periudhën e parë fillimisht do të bëjmë caktimin e objektivave, qëllimeve, grumbullimin dhe përzgjedhjen e materialit, shqyrtimin e literaturës dhe definimin e temës. Pastaj do të jetë përfundimi i projektpropozimit, shqyrtimi i literaturës bazë dhe akademike si dhe klasifikimi i literaturës me pëshkrimin e materialit të grumbulluar.

Periudha e dytë do të jetë analizimi i romaneve të lartpërmendura, metodat të cilat do t'i përdorim gjatë këtij punimi për të vazhduar me interpretimin, citimin dhe dokumentimin e burimeve dhe analizimin e tyre. Gjithashtu do të merremi me analizimin e gjetjeve, sistemimin e tyre, rezultatet e pritshme dhe bibliografinë.

Në periudhën e tretë do të bëjmë futjen e të gjeturave, shkrimin e punimit, redaktimin e punimit, përfundimin si dhe lidhjen.

## KAPITULLI II

### Figura e gruas brenda periudhave të letërsisë shqipe

Nëse fillojmë që nga periudhat më të hershme të letërsisë shqipe, duke u mbështetur në një periodizim që pranohet nga të gjithë, shohim se për figurën e gruas filloi të shkruhet më në hollësi në periudhën e bejtexhinjve, periudhë kjo e karakterizuar me motivet e huazuara orientale. Shoqëria shqiptare ka qenë tradicionalisht e mbizotëruar jo thjesht nga meshkujt, por nga normat, autoriteti dhe vendimarrja mashkullore. Problemi gjinor në shoqërinë shqiptare ka pasur dhe vazhdon të ketë përmbajtje më të gjerë se sa mungesa e mundësive apo pabarazia gjinore. Gratë kanë qenë të pranishme me rolin e tyre në mjaft ngjarje të rëndësishme shoqërore e politike dhe beteja historike të kombit, por prania femërore në udhëheqje ka qenë një dukuri e rrallë. Ato kanë përballuar nevojat e mëdha për mbijetesën ekonomike të familjeve shqiptare, por fuqia e tyre e tregut të politikës dhe të punës ka qenë e dobët. Gratë, kanë pasur dhe krijuar potenciale të mëdha zhvillimi, por ato nuk kanë mundur t'i sendertojnë dhe mobilizojnë këto energji në zhvillimin shoqëror. Pabarazia gjinore gjatë viteve 1920 - 1944 dha ndikimet e veta në zhvillimin shoqëror të Shqipërisë. Vetërespekti dhe vetëprezantimi me vullnet shpirtëror i grave dhe vajzave shqiptare në kohën e sotme, vëtdijshmëria dhe vetëlartësimi i tyre, “*do të shprehin përmbajtjen e emocionale, kënaqësitë apo pakënaqësitë për personalitetin, cilësitë dhe aftësitë, mendimet dhe sjelljet*” (Dragoti, Edmond, 2004:46), duke njohur dhe respektuar aftësitë dhe vlerat e vetes drejt optimizimit për ndryshimin e kësaj situatë të deformuar nën petkun e demokracisë, kundër qëndrimeve të deritanishme të përgjegjësive individuale dhe institucionale, të cilët vazhdojnë t’ia atribuojnë sukseset vetes dhe dështimet në këtë fushë veprimi faktorëve të jashtëm. Nevojat dhe domosdoshmëritë e demokracisë janë më të vlefshme se sa nevojat e individit. Regjimet politike kohë pas kohe, janë pajtuar dhe e kanë shfrytëzuar për interesa të ngushta politike këtë strukturë sociale dhe kulturore të shoqërisë. Ndërkohë, regjimi komunist u veçua nga regjimet e mëparshme, sepse nga njera anë mobilizoi burime politike dhe kulturore për të ashtuquajturin “*ndryshim të ekuilibrave tradicional gjinore*”, ndërsa nga ana tjetër ruajti të pa ndryshuar dhe nuk arriti të ndërhyjë në rrënjët dhe shkaqet kryesore kulturore dhe historike, që shqenin pabarazinë dhe problemin gjinor në shoqërinë shqiptare.



## 2.1 Nga zona e “heshtjes”, në realitetet e ndaluara; pozita sociale e femrës në botën shqiptare të viteve ‘30-të.

Idetë më të rëndësishme mbi pozitën dhe rolin e gruas në shoqërinë shqiptare, janë pasqyruar më gjerësisht në mendimin letrar dhe krijimtarinë letrare të shkrimtarëve shqiptarë të kohës. Kjo, nuk ishte e rastësishme. Mendimi letrar dhe krijimtaria letrare gjatë viteve 1920 - 1930, ishin produkti më i spikatur në mendimin shoqëror shqiptar. Letërsia dhe kritika letrare, ishin hapësirat kryesore të rrahjes së mendimeve dhe ideve mbi zhvillimin e shoqërisë. Në këtë kontekst, shkrimtarët dhe kritikët ishin jo vetëm kritikët kryesorë të realitetit shoqëror, por gjeneruesit potencial për kohën të ideve mbi zhvillimin, ndryshimin dhe të ardhmen e shoqërisë. Është fakt që, filozofët dhe sociologët shqiptarë të kësaj periudhe, lindën kryesisht në terrenin e letërsisë dhe të kritikës letrare. Ky është shkaku që në këtë kapitull, referencat kryesore mbi pozitën dhe rolin e grave në shoqëri, burojnë nga krijimtaria dhe kritika letrare e kohës. Gruaja shqiptare e viteve të periudhës së pavarësisë, dallon nga ajo e cilësuar si jetë e viteve “30- të”. Arsyeja më bindëse qëndron në raportin e saj më të tërën. Para viteve ‘30-të, gruaja vishej me petkun e një simbolike “burrërie”, e cila ishte rrjedhojë e ndikimit që reflektonte në popull çështja kombëtare shqiptare. Citojmë dy vargje nga poema e Fishtës, “Lahuta e Malcis”, në përmbajtjen e të cilave kuptojmë vlerat që përfaqësonte për kohën gruaja shqiptare. “Edhë dielli dheut i ra/ Gjallë por Tringa Shkjaut n’dorë s’ra”. [Elsie, Robert, 1997:295].

Brenda kësaj ekzistence, lidhej dhe gjallonte fati i saj luftarak, virtytshmëria deri në shenjtëri. Kjo veçori historike u krijua si mbirealitet, nga vet hiperbolizimi i faktorit historik. Është një Tringë fishtjane, e cila do i paraprij një heroine si Shote Galica. Dhe pse jemi në fillimet e shekullit të XX-të, kur Evropa falë revolucionit industrial e ngriti gruan në statusin e punëtore dhe kur Lufta e Parë Botërore trokiti në dyert e kontinentit, gratë do të arrinin të merrnin pjesë në procesin e prodhimit të armatimeve në interes të luftës. Këto detaje, së bashku me shkrirjen e tyre në lëvizjet punëtore, sindikaliste, u dhanë atyre vendin përcaktues në shoqëri, të drejtën e votës. Këtë faktor historik do ta shohim më poshtë, kur krahasojmë feminitetin intelektual shqiptar me atë european, duke u nisur nga ngritja e dinjitetit të saj tek përkatësia sociale punëtore. Parë nga ky këndvështrim dualitetesh, ndihet e nevojshme të jemi ende “modestë” në ndryshimin e moralit shqiptar.

Një punëtore europiane e shtyrë drejt vendit të saj në zhvillimin e shoqërisë, duke e nisur të ardhmen përmes punës, e ka brenda këtij formati afërsinë e saj gjinore. Puna është e vetmja vlerë ku dinjiteti njerëzor e kupton dhe e ndjen ekzistencën. Kur i referohemi situatës së femrës shqiptare, do të pranohet konceptin mbi një realitet ndryshe. Arsimiti i tyre kishte qëllim zgjimin e moralit, dokeve, kundër patriarkalizmit mbyllës apo fatit vetëvrasës të një *“ngujimi paramartesor”*. Në kontinentin tonë gruaja punëtore ishte e aftë të mbante familjen, por dhe të gjendej një ditë *“e ve”*, nën pasojat e divorcit. Për studimin e situatës brenda jetës shqiptare, duke iu referuar vërtetësisë letrare në njohjen e botës shqiptare, nisemi nga dy krahasime letrare, nga atdhetari Pashko Vasa me romanin e tij *“Bardha e Temalit”*, botuar në Paris më 1890, dhe Henrik Ibsen me dramën *“Shtëpia e kukullës”*, botuar më 1882. Do mjaftonte një raport krahasues i thelbit të përmbajtjes së tyre, për të kuptuar shumë kundërshti në gjendjen dhe të drejtat e gruas. Autori shqiptar e trajton të drejtën e femrës në tragjizmin e saj brenda dashurisë, duke rikrijuar skena në roman, të cilat herë të kujtojnë *“Ferrin”* dantesk, e herë ledi Makbeth. Në rastin e Norës së Ibsenit, e drejta e saj nuk qëndron tek pasioni, flijimi romantik, por tek dashuria e të qenit femër dhe respekti ndaj vetes. Mbi të gjitha, citimi i saj në mbyllje të dramës së: *“Këtë e kanë bërë mijëra gra Torvald...”* (Ibsen, Henrik, 1882:47,121), shpjegon gjithçka. Sipas kritikës, nga që Ibsen ka qenë estetikisht tejet realist dhe i drejtpërdrejtë, heroina e tij do mbetet një nënë, duke e *“fshetur”* qenien e saj si grua. Kjo për vetë dëshirën dhe vullnetin e saj emancipues. Në fillimi të shekullit të XX-të, sidomos gjatë dekadave 1920 dhe 1930, mendimi letrar shqiptar e pasqyron femrën shqiptare herë si *“profeci”* naimiane brenda panteizmit, e herë plot *“Migjen”*. Konstatohet një *“ishullim”* femëror shqiptar, i mbyllur deri në kycje për çdo të drejtë. Por nga ana tjetër, kur femra hyn në *folklorizëm*, ajo paraqitet si qenie gati e paarritshme. Në këtë marrëdhënie që e fsheh deri diku gruan shqiptare, është morali burror kombëtar, i cili nuk i lejon asaj të kuptojë se çfarë mund të përfaqësojë. Po t’i referohemi në thelb e drejtpërdrejtë dy botimeve të mësipërme, do të duhej të zbulonim së pari; se përtej një nëne, amvise, luftëtare, në shumë raste e mbetur në vetminë e saj, normalisht do të shtrohej pyetja: çfarë mund të ketë bërë në jetën e saj kjo grua e *“tretur”* dhe pa identitet real? Përrjashtohet në këtë vlerësim Migjeni në rastin që shpreh një anonimat, si moslejim për të ndryshuar një Shqipëri kaq dramatike, me plot tragjizma dhe mbetje prapa kudo! Deri në fund të viteve ‘20-të, gruaja përshtatej brenda patriarkalizmit në kufijtë vrasës. E ngujuar kudo, ajo ishte thjeshtë një *“riprodhuese”* djemsh.

Në raste të tjera, ajo mallkohej nga burrëria krahinore si e pazonja për të lindur të “*shtëna*” dhe jo të “*qara*”. (Kanuni Lek Dukagjinit, 2005:10-21). Historiku i shtypit shqiptar jep mes emrave të pendës së gazetarisë, vetëm një grua: Ikbale Çika (Marku, Mark, Boriçi, Hamit, 2010:200). Ishte gazetare dhe bashkëpunëtoreshë mes morisë së intelektualëve, të cilët këtë realitet lajmi e kishin pjesë të qenësisë së tyre politike, letrare, studimore. Pra, duket se me nisjen e arsimit, do niste realisht ndryshimi i gruas shqiptare. Sipas studimit mbi historikun e shtypit, “*kjo dekadë deri para pushtimit italian, do ketë shumë divergjenca brenda vetë kësaj bote, sa e lajmit, por e kundërshtive mes grupeve intelektuale*”. Gazeta shihej si mjet publik, për të treguar forcën me ithtare “*lexuesish*”. Ishte koha e ndarjeve të mëdha si kudo, mes të Vjetërve dhe të Rinjve. At. Gjergj Fishta, na ndihmon të kuptojmë çfarë ndodhte realisht me këtë shtyp: “*Por ç’se ia hynë me shkruem në gazeta njerëz batalla, rrugaça, derdimena, studentë të ramë në provime, smirëzez, të cilët pa dijtë gjuhë, pa pasë zeje e dijeni në punë, me do parime morale e shoqnore, kryekëput në këndërshtim me parime të qytetnueme, përllajnë pendën krejt si gjaksbasi thikën e nën tallazgan, gjerentit përgjegjës, mësyjnë njerëz të punës dhe dijes...*”. [Marku, Mark, Boriçi, Hamit, 2010:199-200]. Siç konstatohet në vet thelbin e këtij mendimi, poeti, kishtari, patrioti, gjithçka që ia kërkonte vendi së paku në përparim të dijes, e ka pasur të qartë se shtypi nuk mund të ndahej prej “*krahinarizmit*” intelektual. Një formë e të shprehuri me mungesë etike, e cila e zbrazë vet lexuesin nga qëllimi informues. Ky krahasim jep të drejtën e mendimit mbi vet fatin ende të padukshëm të rolit të femrës së kohës në atë botë elite, por e mënjanuar nga vet diferencat e mëdha, deri në skaje të njeriut të dijshtëm dhe epidemisë vdekjeprurëse nga mos mbërritja në kufijtë e një kulture masive.

Pra siç shihet, vendi i gruas, e cila në fundin e viteve ’20-të nisi të ndjehet pjesëmarrëse, kjo dukuri pozitive ndodhi për shkak të arsimit. Me ngritjen e shtetit gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare, nisi të krijohet atmosfera elitare. Femra shqiptare nisi të gëzojë të drejta, në fillim falë pasurisë dhe përkatësisë prej familjeve të mëdha. Shfaqet, lojërat sportive, veshja dhe përshtatja me ndikimet e perëndimit, mundësuan këtë hapësirë emancipimi. Sipas burimeve arkivore, në Korçë u zhvilluan dy aktivitete; garat sportive dhe “*Miss Korça*”. E veçanta e dukëshme dhe intriguese ishte veshja sportive me rroba banjoje, pa dallim nga paraqitjet në vendet e tjera.

Nga ana tjetër fal kësaj pasurie dhe ndikimeve të kolegjit “Nana Mbretneshe”, u reflektua një ndryshim i pakthyeshëm drejt një gruaje edukatore fillimisht brenda vetes, e më pas si përcuese e vlerave të saj tek shtresat e tjera të shoqërisë. Bota shqiptare e në veçanti ajo femërore, analizohet kryesisht nga mendimi letrar dhe përmes faktorëve letrarë. Një pikënisje e tillë vjen nga krijimtaria e shkrimtarit Haki Stërmilli, me romanin, “*Sikur të isha djalë*”. Vetë drama e vajzës për të guxuar përmes dashurisë, tregon më së miri se emancipimi gruas, vajzës shqiptare, do të kalonte përmes “*ëndrrës*” dhe “*kantierit*” të letërsisë. Duket se kjo shkencë e së bukurës si koncept, por në realitet me vlera përmbajtore, do të jetë “*dalja*” e parë reale e gruas drejt të kuptuarit të vetes. Nga një analizë shoqërore e letërsisë duhet thënë se, nëse shtypi ishte elitë për elitë të vetvetes, ai shprehte dhe një qëllim të shpejtuar në raport me prapambetjen shoqërore. Kështu, letërsia e viteve ’30-të ishte një goditje përballë ngrehinës shoqërore, e cila duhet të godiste kundër faktit që kjo ngrehinë fshihte në përbërjen e saj ndërtuese kolona mbajtëse me përmbajtje orientale. Do të duhej kohë, që Shqipëria të ecte drejt të drejtave politike e civile të grave. “*Barazia në të drejtën e votës midis burrave dhe grave në Shqipëri, u realizua për herë të parë në vitin 1946*”. Paragjykimi i femrës del në pah me një paraqitje të qartë. Femrat ishin të pakta në jetën publike, arsimore e kulturore, siç renditen në historinë e qarqeve mësueset e para, më pas shkrimoret, studentet e rralla, për të mbërritur tek femra që i mungonte në krah elitës mashkullore shqiptare!

Kështu, për një arsye madhore vet raporti letrar i krijuar nga autorët shqiptarë jepte një natyrë komplekse. Letërsia kërkonte të plotësohej me jetën reale. Në pamundësi të saj, ajo krijoi autorin, “*Unin*” e tij vetmitar. Këta autorë, të lexuar me të gjitha prirjet bashkëkohore nga filozofia, psikoanaliza freudjane, karakteri emancipues i femrës si personazh në letërsinë evropiane, u detyruan të zgjidhnin; ose të ishin imitatorë, por do ta ndëshkonin veten me termin “*Vdekja e lexuesit*”, ose brenda kësaj kulture kaq shpërthyes, do hulumtonin ndjesitë e kohës për të zgjuar femrën shqiptare. Reformatorët e situatës së rëndë gjinore e sociale, do të ishin të pakët. Mes tyre u dallua treshja “*mistike*”, Lasgushi si pasardhes naimian, Koliqi dhe Migjeni. Dicka me “*tutje*” do të ishte Kuteli me veprën tabu në raport inçesti, “*Vdekja e Xheladin beut*”. Në artin e Rilindjes në perceptimin ndaj femrës në raportin erotik, dallon Sabri Hamiti: “*Te “Bukurija” e Naimit, ndeshim një rebelim finok, që rri mes mitizimit të atdheut dhe atij të heroit kombëtar. Pra, brenda vetë temës së dashurisë, përgjithësohet, duke “humbur” personalja. Kështu nisin të ndërtohen të gjitha diskurset në raport Unë / Ti, dhe ç’është më e rëndësishme, këngën e dashurisë e kthen në shpërthim të erotikës.*”

*Subjekti i falet tërësisht ekstatës së vet deri në vetëshkatërrim, vetëflim*". (Hamiti, Sabri, 2010:232 – 233).

Ndërsa "princi" i poezisë Lasgushi jep një shkrimje moderne të panteizmit naimian, me atë të një lirie në përjetësi. Në raport grua shqiptare - art kemi një hon, ku personalja jo pa arsye fshihet qëllimthi. Poetëve u mbetet arti për të perceptuar jetën shqiptare, siç takuan "mikesha" jo pak gjatë studimeve të tyre në Evropë. Të mbërritur këtu, ata duhet të guxonin, duke zhveshur "traditën" nga e kaluara dhe duke i kerkuar femres tani në arsimim, të kërkonte me dinjitet liritë njerëzore që i takonin. Pra ishte letërsia, e cila u investua për t'ia dhënë në mënyrë fillestare këtë fitore shoqërore grave dhe vajzave shqiptare. Në nisje të ndryshimit dhe avantazhit të artit, i cili përmes figurës artistike mundi të kurorëzojë mbretërimin real të gruas shqiptare në hapësirën e përpunimit të mendimeve dhe ideve të reja, të cilat shkencat shoqërore ia dhurojnë ende ekzistencializmit të pa eksploruar të njeriut modern, këtu dallon Migjeni. Ai e trajtoi realitetin e shoqërisë shqiptare, sidomos në zonat veriore të Shqipërisë, në gjithë origjinalitetin dhe thellësinë e veprës së tij. Adresoi gjerësisht dhe qartë problemet e shumta shoqërore, duke filluar nga varfëria ekonomike deri tek problemi i gruas, gjendja e saj shoqërore, duke u dalluar në antikonformizmin e tij. Mendimi letrar dhe estetik i Migjenit gërshetohet me mendimin e tij sociologjik dhe shoqëror, duke e bërë atë një ndër mendimtarët shoqëror më të njohur dhe më të përparuar të viteve '30-të. Problemi i gruas dhe pozita e saj në shoqërinë shqiptare, do të trajtohen në novelat e tij, "Studenti në shtëpi". Në këtë vepër, Migjeni do të trajtonte shumë hapur problemin e martesës së vajzës shqiptare me një burrë të moshuar. Edhe pse vet ishte pjesë e një familje borgjeze, përsëri zakonet konservatore ishin shumë të forta në shoqëri. Pavarësisht dëshirës së vëllait për të ndryshuar situatën, ai bie pre e ndikimit të shoqërisë. Martesa, si institucion më vete trajtohet në shumë pjesë të veprës.

*"...E si mos t'i vijë turp. Thonë se varzat pa ndere janë pa turp. Prandaj duhet turpi, turpi që s'të len me ngritë zanin në mbrojtjen e vetvetes prej atyne, prej atyne që të dëshrojnë shumë lumturi. Nuk e due! Jo, deri tash nuk asht ndegjue në farefisnin tonë ajo fjalë nga një vajzë e fejueme. Se secili burrë, çfarëdo qoftë, s'paku mashkull asht. E me ba mos me qenë mashkull"?*

(Migjeni, Nikolla, Gjergj, Millosh, 1989:289).

Tregimi *“Bukën e përditshme falna sot”*, rikujton shprehjen e Dostojevskit se: *“varfëria është nder, skamja fëlliqësi”*. Kur burri kthehet në rrugicë dhe sheh një zotëri të dalë nga dera e tij, do t’i duhet të përballlet me tri dilema; a mundet të jetë njëkohësisht burrë, bashkëshort dhe baba? Ashtu si vetë nëna e Lulit, e cila do mbetet nënë. Ky ishte realiteti dhe gjendja e kohës. Në të gjithë këtë përceptim mbi fatin e femrës shqiptare, a mund të themi se çfarë kanë përfaqësuar vitet ’30-të në kontekstin historik, ku roli gruas ka qenë jo *“letrar”*, por vetëm një *“art”* riprodhues i realitetit shoqëror dhe letërsia një sociologji alternative? Realizmi migjenian dhuroi identitetin e femrës shqiptare të plotësuar si ekzistencë jo *“kombëtare”*, por klasore e sociale. Letërsia dhe studimet shqiptare, sidomos ato letrare e sociale, vendosën në qendër femrën. Mund t’i drejtohem gjithçkaje, por vëmendja përqëndrohet te fati i saj. Kështu, Migjeni i drejtohet murgeshës. Nëpërmjet këtij rasti migjenian, mundemi të shkojmë më afër psikologjinë shqiptare dhe të kuptojmë se si ishte jeta e gruas. Cili ishte raporti i saj me ndikimet evropiane, kur mungesa e arsimit i kishte ngujuar? Cili ishte raporti i grave dhe vajzave shqiptare me besimin dogmatik që mbizotëronte në shoqëri, me prapambetjen deri në shit - blerje të fatit? Migjeni këtë gjendje e paralajmëroi, duke e afruar me fatin e tij. Një fat, ku pyetjet mbi jetën kishin një përgjigje; e vjetra duhet shembur! Kështu shkruan Migjeni: *“Unë dhe ti murgeshë dy skaje të një litari; / të cilin dy tabore ia ngrehin njëri - tjetrit. / Lufta asht e ashpër dhe kushedi ku do dali, / e pranadaj ngrehet litari dhe përplasen njerëzit”*. (Uçi, Alfred, 2013:242).

A mund të themi se, kjo qenie femërore shqiptare e krahinarizuar, diku më ndryshe se gjetkë, përjashto zonën e juglindjes si Korça, veriun brenda Shkodrës, bën të kuptojmë se murgesha është kudo ku gjendet prania e gruas shqiptare? Madje, ai e fton në një përballje, duke pranuar dhe humbjen. Duke iu referuar studimit shkencor gjithpërfshirës të Alfred Uçit, jo vetëm për Migjenin, por tërësisë e letërsisë shqiptare të stilit migjenian, reagimi ndaj shoqërisë së padrejtë shkon deri në revoltë. Duke e vështruar logjikisht brenda nevojave të qenësisë grua, mund të arrijmë në përfundimin se, *“nëse murgesha i “zhvishet” Zotit, pra nudon ndjenjat para Tij, ndërsa një tjetër prostituon me trupin, nëse do t’i bashkojmë të dy pamjet, ato në thelb mbeten pjellë e keqtrajtimit fizik, shpirtëror dhe përbuzës. Murgesha “prostituon” shpirtërisht dhe pse ruan trupin, gruaja e përdalë dhuron trupin për tragjizmin e saj social. Nga ana tjetër, kjo grua e ruan ndjenjën”*. (Uçi, Alfred, 2013:242). Në shoqëri ndodh ndeshja shpirtërore tronditëse, e pashoqe.

Murgesha sipas Migjenit, çon në dashni me shenjtët. Nga ana tjetër poeti lutet për drejtësi sociale: “*Mos u lut për mue / se pash më pash due t’i bij ferrit*”. Në kushtet e tragjizmit të jetës, njeriu shqiptar e kërkonte këtë drejtësi shoqërore. Trajtimi në kohë është bindës, real dhe pa luhajtje intelektuale e artistike. Realizmi migjenian është si një “*uragan*”, ku e drejta e jetës ende zvarritet herë mbi dhe, e herë askund. Nga ky dialog poet - murgeshë, kuptojmë shumë më tepër se një statistikë sociologjike apo e dhënë historike. Femra shqiptare ishte e paplotësuar. Kjo e bënte atë të ndjehej e fyer nga prapambetja që e reflektonte statusi i saj shoqëror, politik dhe arsimor. (Uçi, Alfred, 2013:104).

Migjeni e mori femrën nga zona e “*heshtjes*” dhe e përcolli në realitete të ndaluara. Kjo ishte një përgjigje dhe reagim ndaj pozitës së saj sociale në botën shqiptare të viteve ‘30-të. Zhvillimi i gruas në shoqëri nis nga vetëdija e saj seksuale. Ky është një koncept studimor sociologjik, të cilin poeti e jep nëpërmjet trajtimit letrar të faktit. Migjeni nuk ishte i pari që adresonte këto tema. Ai veçohet nga të tjerët për “*instikte të zhveshura*”, jo të fshehura. Veprat teorike që kishin tendenca të studimeve shkencore në dallimin thelbësor midis trajtimit biologjik [të Koliqit] dhe instikteve në përgjithësi, marrëdhënieve dhe trajtimit estetik të temës prej artit dhe letërsisë, filluan të bëhen gjithnjë e më të njohura. Këto raporte intime kanë qenë në një kuptim, vet thelbi i zhvillimit historik dhe shoqëror shqiptar. Mes Migjenit kritik dhe Migjenit mendimtar e shoqëror, ka një dallim në mënyrën e konceptimit dhe të shprehjes në artin e tij letrar. Ai jep “*zonat e heshtjes*” në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, herë të pathëna e herë të mos përmendura kurrë. Të gjitha këto imazhe të mjegullta, ndihmojnë të kuptohet qartë vet fati i femrës në një kohë të vështirë. Mbyllja e saj ishte kaq dramatike, sa cilido autor përveç Migjenit, do të kërkonte ndryshimin e femrës përmes një romantizmi kombëtar.

Duke iu referuar përgatitjes kulturore të letrarëve, në kohën kur Evropa kishte larmi shkollash letrare, krijimtaria e tyre përgjithësisht nuk i përgjigjej nevojave më ekzistenciale, përjashtoj rastin e poetit Migjeni. Të tjerë e kanë parë rolin e gruas në letërsi vetëm si pohim se, ajo duhet të ketë vendin e saj, kryesisht si produkt dhe më pak si faktor i zhvillimit. Evropa, pas simbolizmit të viteve ‘20-të të shekullit XX-të, përjetoi pothuajse të gjitha shkollat letrare, përfshirë prirjet e reja të shkencave të psikanalizës. Ndërsa me aplikimin e të drejtës së votës për femrën, do të fillonte të ndihej roli i saj kudo. Mendimi letrar - sociologjik shfaq hapur kërkesën për të takuar gruan ideale, jo nga pamja, por nga plotësia e saj kulturore.

Do mjaftonte ky fakt nga realiteti viteve '30-të, për të kuptuar se zhvillimi i vendit përcakton premisat dhe mundësinë e një barazie gjinore. Por kur një burrë nuk gjen punë, kur gruaja nuk ka asnjë lloj profesioni, në kushtet kur patriarkalizmi ka bërë aleancë me prapambetjen dhe frenimin e ndryshimit, atëherë “*Kanuni*” modern nuk është asgjë më shumë, por mbetet një mallkim urban. Te proza e Koliqit, “*Hanë gjaku*” (Koliqi, Ernest, 2009:14,27), kemi një ngutje të autorit në kërkim të gruas, për të cilën çdo autor do donte ta kishte lexuesen e parë. Kjo prozë, e shfaq Koliqin të drejtpërdrejtë përballë kohës. Vajza e kësaj fabule sapo është “*kurorëzuar*” me dije e arsimim, si një qenie sociale, e cila pasi kapërcen të gjitha tabutë, është në pritje të kësaj “*Hëne...*”. Ajo është e arsimuar dhe ky investim e vendos atë një hap para djalit në krah. Koliqi mbërrin në dy përfundime të thelluara shkencore: e para, vajza e arsimuar ka jo vetëm guxim, por dija i ka zbuluar të drejtat e saj femërore; e dyta, djali është ende i traumatizuar nga një masakër e ndodhur rreth viteve 1900.

Metamorfoza e mendimit dhe e veprimit në një kohë dhe periudhë të caktuar, janë pjesë të jetës së përditshme të shoqërisë njerëzore. Në çastet më të rëndësishme të saj individët dhe shoqëria pësojnë ndryshime cilësore, të cilat me kohën kthehen në tipare dalluese, të denja për t’iu nënshtruar studimeve të mëvonshme. Ajo rrëfen karakterin individual të autorëve të kohës, me tendenca përgjithësuese. Ideatorët letrarë të kohës nuk menduan mbi padobinë e krijimeve të tyre të spikatura, as mbi rrezikshmërinë sociale brenda një kohe të zhytur në paragjykime e errësirë. Arsyetimi logjik i situatës kohore mbi dukuritë e saj në jetën e femrës shqiptare, e trajtuar në mënyrë artistike, i shkonte për shtat gungës patriarkale të jetës shqiptare. Koha kërkonte ndryshimin.



## 2.2 Ndryshimi i gruas buron nga arsimi: shkollimi si ngushtues i pabarazisë gjinore.

Gjatë viteve '30-të ishte krijuar një gjendje shoqërore, shpirtërore e morale, ku atdheu dhe atdhedashuria shihej si ndjesi mbi ndjesitë. Nga ky këndvështrim kuptojmë se, ndryshimi i gruas ishte konceptuar së pari, nga arsimimi. Arsimimi të çon tek puna. Puna të jep të drejtat. Të drejtat të lejojnë zgjedhjet. Arsimimi i vajzës tek Koliqi, ka ardhur si akt heroik i krijuar nga djali, etërit e tij. Ndaj ai moralisht po merr jo një ndjesi, por barazinë gjinore. Por të dy të “dashuruarit” perballe kesaj “*njolle gjaku*”, vijojnë në drejtimin e kundërt. Bazuar mbi realitetin intelektual të kohës, Jorgaqi ka dhënë një shembëllim të gruas, e cila kishte nisur të krijonte profilin e vet mbi vlerat e përfutuara nga dija:

*“...vetëm nga fundi i Rilindjes u dukën emrat e dy intelektualeve të para në jetën shqiptare. Këto janë motrat Qiriazi, Sevasti dhe Parashqevi, që ngritën shkollat shqipe, hartuan tekste shkollore, nxorën revistën “Ylli mëngjesit” në SHBA. Prej tyre do kemi vargjet e para, siç qe himni Kongresit të Manastirit...Ishin këto sprova premtuese, shkrime me nota didaktike e frymë patriotike, që i shërbyen shkollës shqipe në hapat e para. Siç do jetë dhe nisja e shkrimeve të vargjeve të para...Të thjeshta si krijime. Nga ana tjetër, kjo punë do ndjehet në qytete me zhvillim ekonomik, si Korça, Shkodra, Elbasani, Gjirokastra, Vlora. Por kjo veprimtari bëhej në fshehtësi, jo vetëm nga fanatizmi e analfabetizmi, por mbi të gjitha nga prapambetja sociale. [Jorgaqi, Nasho, 2015: w.w.w.tiranaobserver].*

Përse kjo fshehtësi, kjo heshtje e femrës për të shkruar? Nga kush do paragjykohej e ndëshkohej? Të ngujuar deri përtej “*vdekjes*” me rite jete të një pabarazie hakmarrëse, puna e tyre fillonte dhe mbaronte pa mbërritur në statusin e këtyre grave të denja, për të qenë pjesë e trupës dhe institucioneve ligjvënëse, arsimore, kulturore etj.

*“...Gruaja shqiptare, thekson Jorgaqi, e njohur dhe çmuar botërisht për pamjen, botën shpirtërore, karakterin e veçantë s’kishte si të mos krijonte vargje, dedikuar moshës së dashurisë, të këndonte këngë djepi si nënë, të vajtonte me ligje, të rrëfente përralla si gjyshe. Një realitet i mbyllur në vetëvete...Ndërsa realiteti shqiptar, nga vetë mungesa e zhvillimit, nuk tregonte interes për botën kreative të femrës shqiptare, sidomos për letërsinë. [Jorgaqi, Nasho, 2015: w.w.w.tiranaobserver].*

Ky arsyetim logjik shpjegon “*mënjanimin*” e autorëve burra për të ndërtuar në letërsi rolin e femrës. Jo të femrës si qenie jetësore, por të figurës së gruas shqiptare në përgjithësi. *“E dhënë me trajta të idealizuara, bukurie, trimërie, pastërtie morale, qëndrese, themel i përtëritjes së jetës familjare dhe të Kombit (Mëmëdheut), përmendim se, qysh në folklorin tonë të lashtë mesjetar, femra shqiptare trajtohej si qenie hyjnore, e shenjtë, e idealizuar, dhe e përkryer estetikisht. Në folklore, spikat adhrurimi i bukurisë fizike, ashtu dhe i virtyteve morale. E Bukura e dhët, Tanusha, Motra, Zana, Rozafa. Edhe në letërsinë e lashtë të kultivuar me tematikë fetare, ka patur figura të bukura femrash të shenjtëruara si, Sibilat, vajet e Shën Mërisë, etj, por dhe figura të shekullarizuara e emancipuara si, Zelihaja, Erveheja etj, ose Vojsava, Donika, që u aktivizuan e u ripërtërinë dhe në letërsinë shqipe, deri në vitet '30-të. Po kështu, në fillimet e letërsisë romantike, janë krijuar sërish figura të bukura mbresëlënëse femrash si, Rina, Mara, Bardha e Temalit, Afërdita, Zoga etj. Në periudhën e Pamvarsisë zuri vend figura e femrës në poezi dhe në prozë. Spikasin për bukurinë magjepsë Vashat Lasgushiane, por dhe femrat në kushtet e një pabarazie sociale midis burrit dhe gruas në romanet, “Sikur të isha djalë” të H. Stërmillit, “Pse” të S. Spasses etj. Por Migjeni futi në temën e femrës ide dhe tema të reja”.* (Uçi, Alfred, 2013:356). Adresimi i problematikave shoqërore me qendër gruan, duket sikur prodhonte një art për artin e munguar. Konfliktet letrare si prototip i konflikteve shoqërore, e kanë projektuar gruan shqiptare në mënyrë romantike, si për nga ndjesitë ashtu dhe nga karakteri.

Ky është një romantizëm patriotik. Koliqi, Spasse, Stërmilli, Bulka, Lasgushi etj, përjashtoj Migjenin, do ta trajtonin gruan si një shenjtërim të karakterit, por nuk e *“ftojne atë në mëkate lirie”*. Vitet '30-të i krijuan mendimit letrar dhe në tërësi mendimit shoqëror, mundësinë të shprehur. Prirja progresiste e kohës dhe pikëpamjet demokratike, lindën nevojën e brendëshme për të shprehur publikisht mendimin shoqëror dhe letrar.

*“Kështu në faqet e gazetës “Populli”, dt. 28. 11. 1935, u botua poezia, “Vala gënjeshtare”, që nënshkruhej jo me emër të vërtetë, por me pseudonimin Kolombja. Publikimi kësaj vjershe femërore, u kthye në ngjarje. Jo vetëm u pëlqye, por ngjalli habi dhe skepticizëm. Nuk besohej të ishte shkruar nga ndonjë vajzë. Por ishin intelektualët që e morën në mbrojtje. Njëri nga poetët, Gjergj Bubani, e quan “lule e vetme, që sjell pranverë në shtypin tonë” dhe bën thirrjen: “Dil në shesh moj motër”. Ndërsa studiuesi, gazetari Fiqiri Llagami, do t'i drejtohej opinionit:*

“Kjo vajzë është flamurtarja e evolucionit tonë, që me punën e vet don me rrëxue një shkamb, që ka tabelën e veseve të këqija shqiptare”. (Jorgaqi, Nasho, 2015: w.w.w.tiranaobserver). Lëvizja feministe në vitet ’30-të të shekullit të XX-të, lindi vetëm nga një mundësi: arsimimin. Kjo ishte rruga e vetme, që shpjegonte pafuqinë trashëgimore të shoqërisë shqiptare të kohës. Gruaja nuk gëzonte të drejtën e shkollimit, por frenimi i kësaj të drejte ishte i qëllimtë. Kundër këtij presioni social, mjaft prej tyre u arsimuan. Ishte origjina familjare që ua mundësoi shkollimin. Të kthyer në atdhe nga vendet e huaja, ato kuptuan rolin e letërsisë dhe të mendimit letrar në ndryshimet sociale, si përfaqësuese të denja të emancipimit të jetës shoqërore, kundërshtarë ndaj pengesave dhe imponimeve kanunore, sidomos mbi jetën, martesën dhe familjen. Trishtimi, melankolia, sentimentalizmi ishin ndjesitë kryesore, të krijuara nga mendimi dhe produktet letrare dhe artistike të kohës. Krijuesit e letërsisë, mendimtarët letrarë dhe publicistët po e ribënin atdheun. Por lufta për liri nuk ishte e veçuar nga prirja drejt përparimit shoqëror, jo vetëm drejt atij patriotik. Kolomba, pas së cilës fshihej një vajzë 17 vjeçare nga Gjirokastra me emrin Selfixhe Ciu, do të krijonte një varg vjershash e skicash letrare, të cilat publiku do t’i lexonte në organet e kohës, si “Shtypi”, “Java”, “Diana”, “Drita”, “Bota e Re” etj. Kolomba u bë zëdhënësja e gruas shqiptare, shprehëse e të drejtave dhe e revoltës, përcjellësja e ëndrrave të saj. Pas këtij portreti femëror, kuptojmë jo vetëm angazhimin civil dhe shoqëror, por kuptimin e kërkesave ndaj jetës. Lëvizja feministe e kohës u konceptua e lidhur me lëvizjen për ndryshim politik dhe shoqëror, e orientuar drejt lëvizjeve që ngrenë dhe përmbysin pushtete. Volteri ka shkruar: “Ideja e drejtësisë më duket një e drejtë e kategorisë së parë, kur gjysma e njerëzimit përfaqësohet nga gruaja”. Për të mbrtur brenda shekullit të XX-të ku, “...vota e grave në Francë, dukej se kishin paraqitur kërkesa të forta dhe kishin formuar shoqëritë e tyre drejtuar Shteteve të Përgjithshme” (Xoxi, Koli, 1991:165). Dorette Wesemann, autore e kësaj periudhe, shkruan mbi lëvizjen feministe në Evropë, e cila filloi në vitin 1848 dhe kulmoi me fillimin e Luftës së Parë Botërore, më 1914. Kjo lëvizje kishte doktrinën e vet ideologjike. Marrëdhëniet e reja industriale nuk kërkonin vetëm fuqi punëtore. “Kur u kristalizua lëvizja e grave në shek e XIX-të, feministet e para përpiqeshin të arrinin përmirësime në fushën e të drejtave qytetare [e drejta e divorcit, për kujdestarinë e fëmijës, heqjen e tutelës së burrit në martesë etj]. E drejta e votës fillimisht, ishte e një rëndësie e dorës së dytë në kërkesat e tyre. Por shpejt, do t’i prisnin përvoja të hidhura.

*Pa të drejta, pa zë në sferën politike, ato vareshin nga burrat, ndërkohë që partitë apo organizatat e vjetra, i mbështesnin gratë, për aq kohë sa kjo ishte në interesin e tyre. Nëse qëllimet përmbusheshin, gratë mbeteshin vetëm. Si rrjedhim, vëmendja e tyre u përqëndrua në sigurimin e votës. Ihtare të grave u organizuan në organizata të veçanta, autonome, ose pjesërisht. Gratë e dala në publik mund të ndahen në tri grupe. “Të maturat”. Kërkonin ndryshime hap pas hapi. Brenda kuadrit të shoqërisë qytetare. Theksonin se ishin ndryshe nga burrat, pra kishin detyra të tjera nga burrat. Në këto grupe bën pjesë shoqata të krishtera bamirëse, të cilat kujdeseshin për gratë e varfëra, por dhe shumë shoqata liberale për emancipimin e grave dhe gra konservatore. Shumë prej tyre u bënë me nisjen e LIB militante në mbrojtjen e atdheut”. (Wesemann, Dorette, 1848-1914:[http:// www.dadalos](http://www.dadalos)),*

Fundi i shekullit të XIX-të dhe fillimi i shekullit të XX-të, ofruan shumë zgjedhje. Në këtë periudhë u krijua realisht koncepti mbi kuptimin e pranisë së gruas në një botë të ndryshme dhe që po ndryshonte. Këto jehona mbërritën edhe në Shqipëri. “Radikalet”, si shoqata grash me prejardhje borgjeze, kuptonin dhe shkonin përtej pasurisë, duke insistuar për barazinë gjinore në të drejtën e votës. Kodet civile mbi familjen, pasqyronin dhe tentonin të zgjidhnin konfliktet mbi trashëgiminë. Gratë e përfshira në këto lëvizje ishin të pasura, por nuk zotëronin statusin e duhur social dhe klasor. Disa prej tyre u përpoqën të lidheshin me gra socialiste, për të siguruar një liri aktiviste, si instrument për të ndryshuar mentalitetet shoqërore dhe politike.

Një grup tjetër përbëhej nga gratë socialiste. “Ishin gra të organizuara në mënyrë relativisht autonome, brenda lëvizjes socialiste dhe më vonë ato komuniste. Bazë për kërkesat e tyre, janë ndryshimi i ligjëshmërive që krijojnë ndarjen e pasurisë sipas klasave. Njëra nga ideatorët e kësaj lëvizje ka qenë Klara Cetkin. Ato kërkuan hierarkinë e gjinive në mënyrë të ngjajshme me shpërbërjen e klasave. Në qendër të kërkesave të tyre, është krijimi i barazisë ekonomike mes punëtoreve femra dhe atyre meshkuj [e njejta gjë për secilën punë, krijimi i sindikatave të grave.]. Festimi i ditës ndërkombëtare më 8 mars, vjen nga gratë socialiste”. Një mbledhje e grave të majta europiane bën thirrje: “Në përputhje me organizatat politike dhe sindikaliste të klasës së proletariatit në vendin e tyre, gratë socialiste do organizojnë çdo vit një ditë të grave, e cila i shërben në radhë të parë agjitacionit për të drejtën e votës. [Wesemann, Dorette, 1848-1914:<http://www.dadalos>.]

Duke ju referuar botimit të “*Historisë së Bektashizmit*“, dalin në pah disa fakte që shpjegojnë liberalizimin e këtij besimi tradicional shqiptar qysh në fillim të veprimtarisë së tij në trevat shqiptare dhe disa dukuri që tërheqin vëmendjen, veçanërisht qëndrimi ndaj grave e vajzave dhe familjes;

1]Liria dhe nderi i grave në barazim me burrat.

2]Faljet dhe agjërimet e pakta, por të mira dhe të plota.

3]Rregulli i jetesës shtëpiake në dashuri të plotë, bindje, barazi, punë dhe pastërti shembëllore.

4]Lindja e kësaj doktrine në një fshat të vogël të Anadollit dhe përhapja e saj me hapa të shpejtë në të tre kontinentet e pushtuara nga perandoria otomane ...(Turabiu, Ali, 1929 :23).

Bektashinjtë kishin shpallur besimin e tyre te pavarur në vitin 1921, i cili u miratua si status në vitin 1923. Largimi i tyre nga ndikimi turk u shoqërua me ngritjen e qendrës së tyre në Tiranë, e cila u bë zyrtarisht Qendra Botërore e Bektashizmit. Organizimi institucional i tyre ishin teqetë që drejtoheshin nga babai ku shërbenin dervishët. Fryma kombëtare e këtij besimi shfaqej hapur në kohë të herëshme. “*Varfë Meleq, Tahir Staravecka* [në kohën e fundit Baba Meleq Shëmbërdhenji] *tridhjet vjetë me radhë, shëtiti Shqipërinë fshat më fshat, nga Ulqini gjer në Prevezë, duke përhapur libra për rilindjen e Shqipërisë, e të gjithë teqetë, hynë në formën e shkollave kombëtare, duke predikuar “Qerbelanë”, përkthyer me poezi të gjallë prej të pavdekshmit vjershëtor, Naim Bej Frashërit*”. (Turabiu, Ali, 1929:55). Gjatë luftës, kleri bektashian u rradhiti pro Frontit. Pas çlirimit të Shqipërisë, ata u deklaruan pro qeverisë, dëshmuan vullnetin e tyre me ndihma për popullsinë. Ndërkohë, në shtypin e kohës, në të vetmin organ zyrtar, gazeta “*Bashkimi*”, aktiviteti i Kryegjyshitës Botërore ishte gjithmonë i pranishëm në përkrahje të politikës së pushtetit popullor për t’iu përgjigjur pozitivisht thirrjeve të tij. Në një prej numrave të gazetës shkruhej: “*Më 10 të këtij muaji, u çel mbledhja e këshillit të komunitetit Bektashian në qëndër Kryegjyshitën Tiranë. U bisedua pjesëmarrja e fetarëve bektashinj në aktivitetet për rindërtimin e Shqipërisë së re Demokratike. Bektashinjtë kanë qenë çerdhe të patriotizmit, duke dhuruar bijtë e saj dëshmore si, Baba Abas Rabia, Baba Fejzo Martaneshi, Baba Fejzo Krahasi. Ky bisedim u mbyll, duke sajuar vullnetarisht prej çdo Teqeje ndihmë për asistencën sociale në një shumë prej 67. 100 fr shqiptare.* (Gazeta “*Bashkimi*”, 1945, nr.46:2).

Megjithatë edhe pse bektashinjtë dervish dhe baballarë morën pjesë në luftë kundër forcave okupatore, duke arritur dy prej tyre gradën e “kolonelit” si, Baba Faja Martaneshi dhe Baba Fejzo Dervishi, presionet ndaj tyre nuk munguan. Si pasojë udhëheqësi i tyre i lartë, Dede Abaz Hilmi, u vetëvra në marsin e vitit 1947, pas pretendimit se, “*ai kishte vrarë me pistoletë dy baballarë me shumë influencë dhe të afërt me Enver Hoxhën*”.

Krahas klerit Bektashi edhe ai Ortodoks, njohu pushtetin popullor dhe u deklarua pro tij. Kishat Shqiptare të Amerikës lëshuan thirrjen: “*Kishat Shqiptare të Amerikës u bëjnë apel tre aleatëve të mëdhenj për njohjen e qeverisë demokratike. Të njihet zyrtarisht qeveria shqiptare në Berat, nën kryesinë e gjeneral - kolonel Enver Hoxha*”. (Gazeta “Bashkimi”, 1945, nr.53:4). Në përshëndetje të këtyre lëvizjeve të klerikëve bektashi dhe atyre ortodoks, gazeta “Bashkimi” në kryeartikullin e datës 19 prill 1945 shkruante: “*Shqiptarët e Amerikës, orthodoxe dhe muhamedanë me Konicën dhe Nolin në krye, i duall për zot bashkimit kombëtar dhe çlirimit të Shqipërisë*”. (Gazeta “Bashkimi”, 1945, nr.100:1). Ndërkohë që bektashinjtë dhe ortodoksët kishin shpallur autoqefalinë, kleri katolik vazhdonte lidhjet me Vatikanin, të akuzuar për lidhje me pushtuesit gjatë periudhës së luftës. Marrëdhëniet e mira midis klerit katolik dhe pushtuesve italianë filluan që në vitin 1943, për shkak të lidhjeve të ngushta me Vatikanin. Vasalitetin ndaj pushtimit italian e shpallën edhe krerët ortodoksë, myslimanë dhe katolikë. Në veri lidhja me Italinë ishte shumë e largët, që nga koha e Skënderbeut dhe lidhjet me Venedikun lanë gjurmët e tyre. Kleri katolik pati përfaqësuesin e tij në qeverinë gjermane, të krijuar në vitin 1943.

Në vazhdim, kisha katolike u akuzua si predikuese kundër reformës agrare. Në një letër drejtuar legatës mbretërore për ndihmë financiare nga Qeveria Mbretërore Italiane theksohet se, “*Toka i takon atij që e punon - ky është parimi i ligjit thotë pushteti popullor, ndërsa Krishti nuk ka thënë t’u merret toka e fitume me mund dhe djersë atyne që e kanë dhe t’u epet fshatarëve që punojnë*”. (Gazeta “Bashkimi”, 1946, nr.326:1). Kjo sherbeu për t’i trajtuar klerikët si armiq të reformës. Nisur nga shkrimet e tyre gjatë qeverisjes italiane, siç ishin Pater Giuseppe Valentini dhe Fulvio Cordignano, në revistën “Leka” në kryeartikullin e saj do të theksohej: “*Kush don me krye detyrën, kush do me kenë i drejtë, kush asht gati me u ba fli për të mirën e vëllazërisë, le ta quajë veten fashist*” 1941. (Gazeta “Bashkimi”, 1946, nr.326:1).

Ndërsa Gordignano, në revistën “D’albania” në 1941 shkruante; “*gjithë kjo, sigurisht do të ndreqet nga një aktivitet fetar, në kuadrin e asaj drejtësie absolute, që sot Italia i ka sigurue popullit shqiptar*”. (Gazeta” Bashkimi”,1946,nr.329:1). Gjyqet kundër klerikëve filluan në shkurt të vitit 1946. Prandaj duhet pranuar se viti 1967, nuk ishte sulmi i parë dhe i vetëm ndaj klerit. Gjyqet filluan kundër Patër Anton Harapit, i cili u gjykua për fjalimin e tij të famshëm të Regjencës: “*Mue më ban me dyshue për sinqeritetin e kësaj rryme shqiptare. Masat terroristike mandej vëllavrasja*”. [Gazeta“Bashkimi”, 1946,nr.340:3]. Ndërkohë, në gjyqin kundër tyre u treguan dhe letrat e Patër Gjergj Fishtës, me simpatinë e tij për pushtuesit italian dhe ndihmën që ata po i jepnin popullit shqiptar; “*..për të ngritur nga mizoria shumë shekullore popullin e mjerë shqiptarë*”. (Gazeta “Bashkimi”, 1946,nr.340:3).

Don Lazër Shantoja, Patër Fausti, Baba Qamil Gllava, Dede Abaz, Sheh Ibrahim Karbunara, Emezot Viçenc Prendushi, Sali Myftia, Sheh Zenel Fratari, Xhemal Naipi, u cilësuan si tradhëtarë, sabotatorë, komplotistë, bandë kriminale. Myftiu i Durrësit, Mustafa Varoshi, Xhovalin Vllashi, dhe klerikë të tjerë katolikë, të cilët u quajtën “*grupi i Durrësit*”, në lidhje dhe bashkëpunim me deputetë si, Riza Dani, u akuzuan për shërbime ndaj të huajve dhe Vatikanit. Po në këtë vit, në qendrën e Kryegjyshitës Botënore në Tiranë, u vranë Baba Fejzo Dervishi dhe kolonel Baba Faja Martaneshi, për të cilën u akuzua padrejtësisht Dede Baba Abas. Pra, u eliminuan figura të shquara të luftës kundër pushtuesit. Në atë kohë, E. Hoxha do të shprehej: “*Në këtë luftë vigane të popullit t’onë, u shemb nga themelet shoqëria e vjetër e privilegjeve dhe e padrejtësive, nga gjiri i popullit u ngrit pushteti popullor. Tashmë u thyen zinxhirët e beut për t’i dhënë fshatarit dritë dhe kulture, për të hapur rrugë, shkolla, kanale, spitale, për të ngritur nivelin e jetesës*”. (Gazeta “Bashkimi”, 1947,nr. 856:2). Dobësimi ekonomik, pas reformës agrare dhe ai politik pas statutit, u shoqëruan me valë të egra represioni ndaj klerikëve dhe me fushata agresive në shtyp, në shkolla, instuticione apo organizata të tjera shoqërore. Filloi një konfrontim i pashoq me klerikët, i cili u instrumentalizua nga organet e sigurimit, nëpërmjet direktivave të partisë për të realizuar edukimin ateist të shoqërisë, më tepër të brezit të ri. Në programet shkollore, nuk iu bë asnjë lëshim botëkuptimit fetar. Lufta kundër fesë u intensifikua në fshat, ku ishte numri më i madh i besimtarëve.

Në këtë mjedis të prapambetur, propaganda ateiste ishte e organizuar në të gjitha shkallët e saj, si në organizatat e rinisë, partisë, gruas etj. Të tjerë klerikë, që u bashkuan me organizatat antikomuniste nacionaliste, u vranë duke luftuar me strukturat e regjimit, ose kaluan kufirin drejt Italisë dhe Greqisë. Policia sekrete shqiptare u implikua në vrasjen e dy bektashinjve shqiptarë në ambjentet e tyre, por për këtë vrasje fajësuan kreun e tyre. Pas prishjeve të marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe intensifikimit të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, ndryshoi qëndrimin ndaj fesë, duke ndjekur një politikë më tolerante. Nën kujdesin e Stalinit, regjimi komunist akuzoi Koçi Xoxen për sulme të hapura ndaj fesë. Pothuajse çdo klerik i burgosur, u lirua ose dënimi i tij u reduktua. Një shenjë e reflektimit të politikës antifetare ishte gjithashtu fakti se gjatë viteve 1945 - 1965, u ekzekutuan vetëm dy priftërinj katolik dhe disa kisha të mbyllura u lejuan të hapeshin. Një numër i kufizuar të rinjsh, u lejuan të studionin në shkollat e mesme katolike. Disa prona të kishës, u kthyen përsëri në zotërim të tyre. U rilejua botimi i *“Hyllit të Dritës”* dhe u botuan disa libra fetar. Megjithatë, propaganda ateiste vazhdoi duke përdorur çdo mjet juridik për të penguar funksionimin normal të aktiviteteve fetare. Policia sekrete depërtoi në rradhët e klerit katolik shqiptar edhe pse me sukses të kufizuar. Përveç kësaj u përdorën mjete të tjera ligjore si, tatimet e rënda dhe gjrobat, për të dobësuar ekonomikisht kishën katolike.

Në këtë periudhë [1947 - 1949], u zbut qëndrimi ndaj Kishës Ortodokse dhe u liruan disa klerikë ortodoksë. Në vitin 1949 Kryepeshkopi Kristofor Kisi u shkarkua dhe u burgos. Më pas në vitin 1958, ai vdiq (Jacques, Edwin, 1995:498-500), duke u zëvendësuar nga Kryepeshkopi Pasi Vodica, i cili shpalli se, *“detyra e kishës ishte besnikëria ndaj pushtetit popullor”*. (Jacques, Edwin, 1995:500). Kryepeshkopi vendosi marrëdhënie të mira me patriakanën e Moskës, por këto lidhje nuk do të zgjasnin shumë. Kisha Ortodokse Shqiptare u kthye në një shtojcë të kishës së Moskës. Në këto kushte statuti themeltar i kishës u ndryshua, për t’u përshtatur në një vijë të pandryshuar në raport me politikën shtetërore. Pronat e Kishës Ortodokse Shqiptare po pakësoheshin dhe tjetërsoheshin përditë e më shumë, duke përdorur dhunën fiskale në vend të konfiskimeve. Në fund të viteve ‘50-të, u ndaluan lidhjet episkopale me Patrikanën e Konstandinopojës dhe Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë. Çdo kontakt me këto institucione, ruhej nëpërmjet Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Studentët shqiptarë nuk u lejuan të studionin jashtë në Bashkimin Sovjetik, apo në vende të tjera të krishtera të ish bllokut komunist. Propaganda kundër fesë dhe ajo ateiste vazhduan.



Në të njejtën mënyrë u veprua me myftinjtë, që u liruan nga burgu në 1949. Megjithatë, disa prej tyre kishin vdekur për shkak të torturave dhe trajtimeve të ashpra në burg. Gjatë kësaj periudhe, prona e madhe e vakëfit ishte shpronësuar me mjete të rënda si, taksat, gjobat, shembje të ndërtesave apo kthimit të tyre në magazina apo qendra kulturore. Të detyruar nga presioni, myftinjtë u kthyen në shërbëtorë të bindur të regjimit. Botimi i Kuranit të Shenjtë u kufizua dhe ai u publikua në 1956, pas Kongresit të XX-të të P. K. të Bashkimit Sovjetik. Gazeta e përjavshme e komunitetit mysliman, vazhdoi të publikohej, por për çdo numër duhej të merrte pëlqimin e organeve të pushtetit. Jeta fetare e komunitetit mysliman, por jo vetëm e tij, ishte nën kontrollin e plotë të pushtetit komunist dhe veçanërisht të policisë sekrete. Myslimanët u sulmuan më pak për arsye se, ishin shumë më të varfër ekonomikisht dhe intelektualisht. Pas aprovimit të statuteve të institucioneve fetare pas viteve 1950, të gjitha besimet iu nënshtruan politikave imponuese të shtetit. *“Në këto situata revolucionare, kemi marrë vesh se kryesia e klerit bektashian dhe mysliman, u kanë lëshuar një qarkore të gjithë hoxhallarëve e dervishlerëve të heqin çallmat dhe taçet, të heqin xhybet dhe të dorëzojnë teqet dhe xhamitë”*)

## Kapitulli III

### DISA NGA VEPRAT SHQIPTARE KU TRAJTOHET FIGURA E GRUAS

#### 3.1 Legjenda e Murosjes së Gruas – Rozafati

Rozafa, personazh i motivit arkaik shqiptar, sado që i përket një bote tjetër është po ashtu e viktimizuar për hir të ndërtimit të një kështjelle apo ure, e cila nuk mbante dot pa vënë në themele një krijesë të pafajshme, të çiltër dhe të paracaktuar për t'u flijuar mbi parimin e “besës” fenomen tipik shqiptar, dikur i përhapur edhe në botën antike.

Rozafa është nusja e vëllait të vogël, vëllait më të ri nga tre vëllezërit muratorë, e cila murosset në themel, pikërisht sepse burri i saj e kishte mbajtur besën e lidhur mes vëllezërve, për të mos iu treguar grave, që do të vinte e para për ta sjellë bukën do të murosej në themel të Kështjellës. Ajo është e zgjedhura me besë, është pasojë e mbajtjes së besës me çdo kusht dhe në çdo rrethanë, madje edhe me çmimin e jetës. Ashtu sikur Ifigjenia edhe Rozafa pajtohet me fatin, por kërkon nga burri dhe kunetërit që njërin kraharor, njërin gji, t' ia lanë jashtë murit ku do të murosej me qëllim që ajo t i jepte qumësht djalit të porsalindur. Për dallim nga pasojat tragjike që sjellë në familje, flijimi i Ifigjenisë, Rozafa me aktin e saj të pranimit të fatit nuk sjellë asnjë tronditje. Ajo flijohet, murana mbanë, djali rritet dhe jeta vazhdon. (A. Qeriqi : Fenomeni i Besës në traditën shqiptare, Bujku, 25 qershor 1994).

I vogël e i madh e di legjendën e famshme të Rozafatit, gruas që u sakrifikuara për të ngritur kalanë që edhe sot e kësaj dite qëndron po aq madhështore sa edhe më parë. Në kuadrin e krijimeve të vjetra **popullore**, hyn edhe legjenda e flijimit të njeriut të gjallë në themelet e ndonjë objekti të rëndësishëm për shoqërinë. Ky motiv është i lidhur ngushtë me stadin primitiv të shoqërisë njerëzore. Atëherë njeriu nuk dinte t' i shpjegonte fenomenet e ndryshme të natyrës, prandaj për të fituar hirin e forcave të panjohura mbinatyrore, ishte i gatshëm të bënte sakrifica të mëdha. ( Shala, D., Letërsia popullore, “Shkolla e Lartë Pedagogjike”, Prishtinë, 1983, fq. 179.) Populli shqiptar, në traditën e tij të pasur popullore, krijoi një numër të madh legjendash që këndojnë herorizimin njerëzor në themelet e Kalasë së Shkodrës, të disa urave dhe kishave. Pra, motivi i flijimit njerëzor në traditën tonë është shumë i përhapur dhe shumë i vjetër.

Legjenda thotë:

“Kalás ia vénë themelet tre vallzen të martuem; por shka punojshin ditën, u rrxohej natën.

U duket një shéjt e u thotë m`u lidhë me besë e me fé mos mu diftue gjâ tu shpija, pse kalaja ngréhej si te vorrohej n`mur mâ e para grue, qi t`u binte të nesërmen bukën.

U lidhën vllazënt; por dy të parët e thyen besën e i vogli e mbajti; kështu qi e shoqja e të voglit e pat rrëzik m`u vorrue në múr e atëherë u ngréh kalaja.( Palaj, B., dhe Kurti, D., Eposi i kreshnikëve dhe legjenda, Visaret e Kombit II, “Plejad”, 2005, fq. 295.)

Këtu flijimi i qenies njerëzore të gruas është një domosdoshmëri e përcaktuar, sepse miti i flijimit është bazë mbi të cilën ndërtohet struktura e tërësishme poetike, kurse besa bëhet faktor i drejtpërdrejtë që e përcakton viktimën, duke e shtrirë fajin tragjik mbi tri krijesat më të pafajshme; gruan e re që shquhet për virtytet e saj, burrin e saj, që si njeri të virtytshëm e karakterizon besa e pathyeshme, i cili me shqetësim të anktshëm e pret fatin e tij, meqë nuk di për tradhtinë e vëllezërve, si dhe vetë foshnjën, që duhet të rritet pa nënë.(Fetiu, S., Balada popullore shqiptare, “KOHA”, Prishtinë, 2000, fq. 89).

Gruaja si objekt i flijimit, gati në të gjitha variantet e baladave shqiptare të motivit të murimit është figurë me tipare reale të femrës së zakonshme, të urtë, punëtore e të dëgjueshme, çfarë ishin shumica e grave në familjet patriarkale shqiptare. Atë e karakterizon fuqishëm edhe dashuria e madhe ndaj të birit, ndjenja e amësisë. Pothujase në të gjitha variantet e baladave shqiptare, ajo e parandien fatin e vet tragjik dhe bëhet e vetëdijshme se flijimi është akt i domosdoshëm. Pavarësisht të gjithave, ajo dëshiron ta ruajë funksionin e saj si nënë, sepse kjo është një nyje e fortë që e lidh me jetën dhe me fatin e foshnjës së saj. (Po aty, fq. 90).

### 3.2 Vita, femër revolucionare në romanin Lumi i Vdekur

Ne si lexues bazik gjatë leximit të këtij romani përjetojmë emocione të ndryshme si:

Ekzistencën e individit përballë sprovave të jetës, ku përshkruhen gjerësisht dhe me hollësi lindja dhe vdekja, dashuria dhe urrejtja, gëzimi familjar dhe miqësor, fatkeqësia dhe hidhërimi, miqësia, mëria dhe armiqësia. Asnjë roman para këtij nuk e pasqyron në mënyrë aq komplekse botën shqiptare në prag të Luftës së Dytë Botërore se sa Lumi i Vdekur, ku gjejmë një shtrije të pakufishme të rrëfimit që mbulon plotësisht hapësirën e jetës dhe të ekzistencës së mjedisit shqiptar.

Lexuesi, qysh në momentet e para të leximit takohet me këto familje, anëtarët e të cilave përballen me kushte të vështira ekzistencialiste, pra me dëbimin dhe largimin e këtyre familjeve. Familja e parë do të sprovohet me kthesa të mëdha dramatike. Ajo e Kosovës do të sfidohet nga shija dhe ndjenja e ardhacakut e të huajit, prandaj ishte nënshtruar që t'u përshtatet kushteve të reja të jetës. Ndërsa familja e fshatit Trokth ishte në luftë të përhershme për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe për të siguruar ekzistencën e jetës.

Paralelisht me këto rrjedha dhe në zhvillimin e këtyre ngjarjeve do të ndodhë dhe do të zhvillohet një lidhje intime mes Vitës, vajzës së Pilo Shpiragut dhe Adilit, djalit kosovar të Sulejman Tafilit. Kjo lidhje do të ketë më vonë edhe anën e saj simbolike.

Vërshimet e mëdha që ndodhën në fshat, nga ringjallja e Lumit të vdekur, pastaj prishja e marrëveshjes nga ana e tregtarëve, e bënë Pilon që të mbetej pa asgjë dhe i mbetur në mes të rrugës, pa strehë dhe pa mbrojtje të familjes, ai detyrohet t'i bindet urdhrave të beut të fshatit i cili ia kishte vënë syrin Vitës së bukur.

Personazhi i Vitës, për lexuesin është një tërësi ndjenjash, prandaj gati receptohet nëpërmjet ndjenjave të saj si një heroinë sentimentale. Ajo më tepër përjeton dashurinë sesa jeton me mundimet dhe vuajtjet e përditshme. Vita ka hovin, dëshirën dhe intuitën që duke ndjekur zërin e zemrës së saj të ndryshoj jo vetëm fatin e vet, por duke thyer tabutë i hapë rrugë edhe ndryshimit progresiv të fatit të femrës shqiptare në përgjithësi.

Vita, në shikim të parë duket se bie viktimë e gjendjes së rëndë familjare, atë babai e detyron që të punësohet në oborrin e beut dhe në njëfarë mënyre e sakrifikon atë. Por ky akt i Pilos i mundëson Vitës që të bëjë hapin vendimtar në jetë, bashkimin me të dashurin e saj dhe shkeljen e zakoneve të prapambetura. Megjithatë, veprimi i Pilos, duket veprim i babait që nuk brengoset për fatin e së bijës, shkrimtari i jep atij një kuptim tjetër, më të plotë. Pilo Shpiragu i katandisur si mos më keq nga vuajtjet e familjes së tij, duke bredhur sa në një vend në tjetrin duke synuar minimumin e rehatisë familjare, i ndodhur nën presionin e fuqishëm të gjendjes pa rrugëdalje, detyrohet të ndërmarrë një hap që edhe vet e urrente. Vetëm me një fragment të shkurtër të romanit, mund të shihet mundimi që përjeton Piloja me familje, shihen çastet që tregojnë shpërnguljen e familjes Shpiragu dhe dhimbjet e lindjes që e kanë shtrëngur gruan e Pilos, Rinën. Ajo përpëlitet në qerren që lëviz rrugës me gropa nëpër fushën e Myzeqesë.

-E gjithë rruga që përshkon karvanin ka një domethënie simbolike.

-Varfëria, rruga me baltë, qerret me qetë e lodhura, karrocet e mbushura me njerëz dhe dengje leckash është pra rruga e jetës së familjeve Myzeqare në vitet e 30-ta. Në qerren e Pilo Shpiragut përveç leckave qëndrojnë edhe: plaka me urimet dhe mallkimet e saj, Piloja me zemërimin dhe përgjegjësinë e prijësit të karvanit, Kili i vogël që dremitë nga lëkundjet e qerres, Vita në prag të shpërthimit të vajzërisë dhe gruaja shtatzënë me rënkimet dhe dhimbjet e saj.

Ngjarje dramatike dhe tronditëse do të ndodhin në rrjedhën e ngjarjeve në roman kur Vita dhe Adili vendosin të ikin në mal. Ata tash veç ishin të dashuruar, prandaj edhe kishin forcën të bënin këtë sakrificë sublime. Sakrifika për dashurinë plotësohet më pas edhe nga një arsye tjetër, jeta që ata kaluan në male i bën që më vonë ata të kthehen fitimtarë në Myzeqenë e shumëvujtur. Në këtë mënyrë vjen në spikamë roli anticipues e emancipues i Vitës, vajzës së bukur myzeqare e cila kishte vendosur të lidhë fatin e vetjetësor me një kosovar, e ai është Adili, i biri i Sulejman Tafilit.

Është kjo një simbolik tepër domethënëse, sa njerëzore sa kombëtare, por në veçanti edhe shumë artistike. Roli i veçantë i Vitës si një vajzë e pjekur dhe e formuar edhe për nga mosha s'kishte më shumë se 16 vjet, hetohet edhe në interesimin e saj gjatë udhëtimit të kësaj familje me qerre nëpër rrugët e Myzeqesë.

Kur të gjithë anëtarët qëndronin në qerren e dytë, të mbuluar e të heshtur, ajo kërcen nga qerrja, për të vrapuar shpejt te qerrja e parë, aty ku qëndronte nëna e saj, shtatzënë dhe e sëmurë. Ja një fragment i shkurtër:

Nga bishti i qerres së pasme kërcen në rrugë dhe nga drejt së parës një vajzë nja gjashtëmbëdhjetë vjeçe. Pa ngjëruar asgjëkund, i ra baltës përmes dhe doli në krye të karvanit.

Ishte Vita, çupa e madhe e Pilos.

-Ç'kërkon, moj bijë, që erdhe!...i foli gjyshja. Nuk bënë të rrish këtu, po shko...je çupë e rritur tash ti...

-Nënë, ç'ka nëna?!!

Vita kishte vërejtur se nëna ishte në gjendje të rëndë shëndetësore, prandaj edhe kishte vrapuar te ajo, ani pse kishte kush të kujdesej për të. Ajo largohet vetëm me ndërhyrjen e Pilos. Të gjitha këto segmente Jakov Xoxa i shprehë përmes rrëfimit të qetë, me përfytyrime dhe asociacione të pasura, botën e pasur të personazhëve, në veçanti botën e brendshme dhe veprimet e jashtme të saj. (Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Tiranë, 94) Nuk e dimë nëse Jakov Xoxa i ka njohur lëvizjet feministe, që u zhvilluan nga mesi i tetëqindës e këtej, por, portretizimi i personazheve të tij femërore në roman, na lë të kuptojmë se ai nuk ishte indiferent ndaj tyre.

Ndjenja e dashurisë nuk është më e idealizuar dhe ligjet e jetës së amullt e mbysin atë. Gjatë periudhës së verizmit, nis të shfaqet një tipar thuajse i ri në shkrimet letrare: paraqitja e feminitetit dhe erotizmit, si dhe triumfi i anës fizike dhe i dëshirës, ku fuqia femërore mbizotëron ndaj kodeve morale e shoqërore. Në fillim të nëntëqindës kemi një shpërthim të veprimtarisë së grave shkrimtare, publiciste, aktiviste dhe në avangardë. (Marina Zancan, Il doppio itinerario della scrittura, Einaudi 1998. 103)

Shtypi feminist dënon shoqërinë patriarkale dhe sistemin juridik të shumë vendeve; gruaja nuk është më e destinuar të jetë engjëlli i familjes. Ndershmëria, bindja, brishtësia, pasiviteti dhe vetëmohimi nuk janë më tipare për t'u marrë si model. Pikërisht në këtë periudhë në letërsi lind miti i bukurisë fatale dhe joshëse. Rebelimi i gruas shihet si një goditje ndaj integritetit të mashkullit. Paraqitjet janë nga më të ndryshmet, nga figura virgjërore e pastër e deri te femra djallëzore, që frikëson dhe sillet si alternativë e instinktit të nënës.

Qysh nga “Nanà” e Emile Zola e deri te “Ujkonja” e Vergës, kemi të bëjmë me figura të fuqishme dhe me ngarkesë erotike, aq sa maskulli nuk është në gjendje të lirohet prej tyre, pos me anë të vdekjes. Një paraqitje tjetër interesante që mund të lidhet edhe me autorin tonë, është ajo e femrës si vashë e përhershme. Vajza e jeton me druajtje feminitetin e saj, ndoshta sepse jeton nën hijen e nënës. Zakonisht idealizohet nga autori, është e brumur me sensualitet dhe instinkt natyror. Shpesh krahasohet me imazhet e natyrës apo të kafshëve; shprehet nga një agresivitet i lindur dhe kërcënues, por jo i vetëdijshëm; është melankolike dhe e trishtë; arsyeton vetëm me “zemër”; e jeton sensualitetin e saj me një ndjenjë faji dhe nderi; bie në kontrast shfaqja e saj si e lirë me ndjenjat e fajit dhe të nderit; gërshetohet epërsia si femër me dominimin e shoqërisë patriarkale, që ajo e ka pranuar si të tillë dhe deri diku e lejon:

Nga një drithërimë që i mori gjithë shtatin, Vita shtrëngoi pulpët njëra me tjetrën. "Ai është, ai..." mëlmiti dhe uli sytë sikur të kishte turp nga vetja. Dhe atë kohë, kredhur në një ëmbëliti të panjohur gjer atëherë, kapiti sytë dhe nisi të kotej e lëkundur nga një tallaz që s'e dallonte dot në ish i egër a i butë, sikur në gjumë e me gjumë kërkonte të fshinte a të kapërcente trazimin e madh. E ku i dihet!... Mbase me gjumë rrihte të ndillte një ëndër, kërkonte të shihte qeruar, në dritën e ditës dhe të dashurisë, fytyrën e gjallë të djaloshit, nga i cili i kish mbetur në mend veç qelshja e bardhë, e bardhë...

### 3.3 Serafina Topia - pasqyrë e patriotizmit

Në këtë poemë, romantizmi i De Radës merr ngjyra të forta, pasi linjës së dashurisë midis dy të rinjve i bashkëngjitet edhe linja e luftës kundër pushtuesit të huaj. Si përfaqësues i denjë i romantizmit shqiptar, poeti futet thellë në botën e brendshme të personazheve, sidomos atyre femra.

Pas lirimit nga burgu, De Rada mbeti pa punë dhe u shtrëngua të hynte si mësues privat në një familje fisnike të Napolit. Më 1840, ai botoi poemën e vet të dytë, "Serafina Topia" e cila më tepër sesa një poemë dashurie, ishte një himn për bashkimin dhe vëllazërimin e shqiptarëve. Censura burbone, duke kuptuar idetë lirishtetërore të librit, nuk lejoi qarkullimin e tij. Megjithatë, poeti vazhdoi rrugën e krijimtarisë, duke plotësuar "Milosaon" me këngë të tjera, duke botuar për herë të dytë poemën "Serafina Topia" dhe tragjedinë "Numidët" (italisht).

Tema është romantike, gërshetohet dashuria ndaj të zgjedhuri-zgjedhurës me dashurinë ndaj atdheut, këtu ngadhënjën dashuria ndaj atdheut, sakrifkohet dashuria ndaj femrës apo mashkullit, për hir të dashurisë ndaj atdheut. Serafina, bija e Ndre Topisë dhe mbesa e Gjergj Arianit Topisë, sakrifikon dashurinë që ka ndaj Bozdarit, nipit të Skenderbeut dhe martohet me Nikollë Dukagjinin, duke e respektuar fjalën e prindërve se kjo martesë do të ndihmonte në bashkimin e forcave kombëtare kundër armikut.

Elementet lirike të poemës janë: lindja e dashurisë mes dy të rinjve, Serafinës dhe Bozdarit, ëndrrat vajzërore, frika se mos del diçka që do ta pengojë e ta prishë këtë dashuri e cila konfrontohet në rastin kur marrin vesh prindërit e Serafinës tek e cila dominon arsyeja mbi ndjenjën apo më mirë thënë detyra ndaj atdheut kundër pasionit të dashurisë, kur prindërit e Serafinës me pëlqimin e së bijës së vet, vendosin ta fejojnë me Nikollë Dukagjinin, fisnik i Veriut që do të ndikonte në bashkimin e Veriut të tyre me Jugun e Topiajve për të luftuar armikun e përbashkët, turkun, Bozdari, dashnori i parë i Serafinës, pasi e vret një turk, largohet nga atdheu, më vonë kthehet, merr vesh për gjënë që i ka ndodhur merr vesh për tolerancën e Serafinës .

Bozdari zemërohet ashtu si Akili i Iliadës së Homerit , aq sa nuk intervenon kur po e digjnin të gjallë Evodën me djalin e saj turqit. Në dasmën e Skënderbeut takohet Nikolla me Bozdarin, te Serafina ndodh ajo që i përtëritet dashuria ndaj Bozdarit dhe në konfliktin që lind mes Nikollës dhe Bozdarit, Serafina mban anën e Nikollës këtu vërehet morali i bashkëshortes dhe i nënës.



Në konflikt intervenon edhe Skenderbeu, me autoritetin e tij i ndan të rinjve dhe e shuan konfliktin, te masa paraqiten revolta kundër konflikteve individuale, kur kërkohet unitet për të luftuar kundër armikut të përbashkët. Evokohen kujtime nga lufta para ardhjes së Skëndërbeut.

Serafina është romantike, ka dashuri të zjarrtë ndaj atdheut, përballon ndarjen nga dashuria e parë, po ashtu ka edhe shpirt krijues sepse ajo është autore e këngës për Radavanin ku flet për një dashuri pikëlluese dhe tragjike. Idenë e bashkimit kombëtar e theksojnë të gjitha personazhet kurse Skëndërbeu i takon mendimit se duhet të luftojnë shqiptarët duke u mbështetur në forca vetanake këtu në mënyrë të tërthortë i bëhet kritikë vendeve perëndimore që nuk ndihmuan asgjë edhe pse Skenderbeu luftoi shumë për Evropën në kohën kur gjendja e saj ishte më kritike. Bozdari është personazh romantik kur lufton kundër një ushtari turk dhe kalorsiak kur shpëton një vajzë të panjohur, kontravers kur dashurinë ndaj atdheut e përzie me dashurinë ndaj të dashurit-të dashurës, e torturon veten, vajton buzë detit, zbrast hidhërimin duke dashur të shprehë dashuri ndaj Olimpisë. Radavani është antitezë e Bozdarit, ka dashuri konstante ndaj atdheut, dashuri ideale naj femrës, nuk largohet nga atdheu edhe kur i shkatërrohet lumturia me humbjen e së dashurës Parailës. Dialogët dhe monologët lirikë janë tipare të ligjëratës poetike të kësaj poeme. Kemi idealizim të skajshëm të Skëndërbeut.

### 3.4 Malësorja – viktimë e traditave shqiptare

Romani “MALËSORJA”, i Nazmi Rrahmanit, si asnjë vepër tjetër letrare, e ka pasur ndikimin e vet në letërsinë shqipe, veçmas ka ndikuar në edukimin dhe formimin intelektual të gjeneratave të tëra tek shqiptarët në Kosovë dhe hapësirën e ish-Jugosllavisë. Ky roman që nga botimi i parë në vitin 1965, është preferuar si lekturë shkollore për nxënësit e shkollave fillore, për klasat e larta, si dhe nëpër shkollat e mesme, qofshin ato gjimnaze apo të karakterit profesional. Romani “MALËSORJA”, është roman i karakterit social, por si vepër e këtij zhanri e ka kryer misionin e vet shembullor, në planin edukativ, në aspektin pedagogjik dhe në konceptin patriotik, sepse nuk ka patriotizëm më të madhe se sa me edukuar dhe arsimuar një shoqëri të tërë. Pavarësisht kësaj, nuk mund të përjashtohet mundësia se tek autori mund të kenë ushtruar ndikim rrethanat shoqërore e politike të asaj kohe, por si vepër letrare romani është i zhveshur tërësisht nga ndikimet e politikës, sikurse edhe nga frymëzimet tjera patriotike.

Të gjitha ndikimet e mundshme të kësaj natyre lidhen me formimin intelektual të autorit, me atë frymëzimin e asaj kohe, për edukim dhe emancipim të shoqërisë, e cila në masë të madhe ishte analfabete. Kjo vetëdije dhe ky frymëzim intelektual, u përket atyre viteve kur një shoqëri e tërë ngarendte për t’u shkolluar, për t’u emancipuar dhe për t’u ndryshuar, madje si vetëdije kolektive në Kosovë kemi përjetuar një lulëzim kulturor i cili prekte ndryshime edhe në rrafshin kulturor, arsimor, edukativ dhe pedagogjik nëpër zona rurale dhe të lënash anësh nga kujdesi shtetëror. Në tekstin e shtruar brenda romanit, gjarjet e asaj kohe, rrethanat sociale e patriarkale, autori i ka përshkruar në mënyrë brilante. Thjeshtësia dhe modestia e shkrimit letrar, janë edhe një shtytje tjetër, një vlerë tjetër letrare, që manifestohet si një përshkrim i detajuar, prandaj qasja jonë ka të bëjë edhe me përkushtimin e atij brezi në aspektin edukativ e arsimor, në ndikimin e tyre në vetëdijen kombëtare, duke i apostrofuat aspekte të pabarazisë shoqërore, (edhe pse nuk është theksuar aq), dihet se në ato vite ekzistonte një vullnet dhe ishte ngulitur një vetëdije qytetare e cila ndikoi në ato ndryshime, e kjo kishte ndodhur falë përkushtimit të atij brezi i cili përmes angazhimit kulturor i dha këto porosi të fuqishme, kurse autori i ka përcill përmes formës së shkrimit letrar.

Jeta në fshatin rural në Kosovë, gjithmonë ka qenë e vështirë, arkaike dhe e ashpër për t'u jetuar. Kurse për femrat, (duke i ditur zakonet arkaike e patriarkale), ka qenë edhe më e ashpër për t'u jetuar, për të punuar, për të përparuar dhe për t'u emancipuar. Në romanin "MALËSORJA", ajo jetë është përshkruar me të gjitha karakteristikat e asaj kohe, madje kjo vepër tregon se njohja e autorit me doket dhe zakonet e trevës paska qenë shumë e fuqishme, lidhja shpirtërore edhe më shumë, e kjo njohje e mentalitetit ka nxjerr një përshkrim letrar të detajuar të këtij niveli, për ngjarje dhe ndodhi, andaj përshkrimi i veprës bëhet kaq i thellë, kaq përjetues, logjik dhe mjaftë përmbajtjesor. Zakonisht këto vlera e bëjnë romanin "MALËSORJA" të dalluar, të dashur dhe si vepër letrare më të respektuar. Sigurisht, janë këto vlera letrare e estetike, të cilat kanë ndikuar që romani "Malësorja" të përzgjidhet si lektyrë e detyrueshme shkollore, si lektyrë e preferuar, lexim i sugjeruar, që iu dedikohet nxënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme kudo në hapësirën shqiptare, kuptohet më shumë në ato treva që kishin mbetur jashtë Shqipërisë Socialiste. Gjatë hulumtimit kemi ndeshur në informacione të shumta, dhe sigurisht interesante e mjaft inkurajuese, për përdorimin e këtij romani në të gjitha nivelit shkollor, pra që nga klasat e larta të fillores, nëpër shkollat e mesme e deri në universitete, në të cilat shihet ndikimi i pashmangshëm i këtij romani dhe i autorit në përgjithësi. Natyrisht nuk kemi ndeshur studime të shumta e shteruese, edhe pse as ato nuk mungojnë, por me sa kam kuptuar mungesa e një përpjekje për një bibliografi më të kompletuar është e evidente.

Librat bibliografik, sado të vështirë për t'u bërë, janë tabela rrëfyese për studiuesit dhe hulumtuesit, nga ku zakonisht dalin porosi të vyeshme, ide të caktuara për një vepër e cila arriti t'i përballoj edhe ndikimet politike, mjaft të ashpra, që i prodhonin situata dhe ndikime nga politika komuniste e sistemit rozë jugosllav. Gjatë këtyre hulumtimeve kemi hasur në informacione, në të cilat shihet se romani "MALËSORJA", është pjesë e programeve shkollore edhe nëpër universitete të tjera, aty ku mësohet Albanologjia, ku janë marrë fragmente për nevojat e mësimin akademik të shqipes, po ashtu fragmente nga ky roman gjejmë edhe nëpër libra "Gjuha shqipe", për klasat e larta të shkollës fillore ose nëpër ato të mesme. Kritiku letrar dhe studiuesi i letërsisë shqipe, akademiku dhe profesori universitar dr. Sabri Hamiti, ka bërë një studim të përmbledhur për romanet e Nazmi Rrahmanit, duke përfshirë edhe romanin "Malësorja", por dr. Sabri Hamiti, edhe më vonë në kontingjentin e gjerë të kritikës letrare, nëpër disa fragmente do t'i rikthehet këtij romani dhe do ta citojë në kontinuitet prozën e Nazmi Rrahmanit.

Ndërsa një studim më të kompletuar, për romanin “MALËSORJA”, vite më parë, e ka botuar profesori universitar dhe ligjëruesi i teorive letrare dr. Zejnullah Rrahmani, “MALËSORJA E NAZMI RRAHMANIT OSE ARTI I INTERPRETIMIT”, në të cilën janë analizuar në mënyrë të spikatur disa aspekte letrare e estetike të këtij romani. Por për t’iu rrekur një studimi më të kompletuar për romanin në fjalë, përveç këtyre njohjeve dhe përgjegjësisë profesionale, janë edhe njohjet e drejtpërdrejta me autorin, të cilin për vite me radhë e kam pasur redaktor dhe botues të librave, poetik e publicistik...

Hajria është personazhi kryesor i romanit; ajo është personifikimi i vuajtjes së femrës së nënshtruar dhe të shtypur shqiptare në Kosovë e më gjerë. Vuajtjet e saj janë të shumta, por më të madhen autori ka spikatur dhimbjen e nënës për djalin që ia kanë marrë me forcë dhe tani ai është i rritur. Rrëfimin e historisë së vet para djalit Hajria e quan roman, një roman të pashkruar, kjo për dy arsye: asnjëherë fëmija nuk mund të njohë aq shumë thellë historinë e prindit të vet, aq më tepër në këtë rast kur biri i Hajries është rritur larg prehërit të nënës së vet. Kjo e bën dhe më tragjike dramën që fsheh Hajria përbrenda. Drama e Hajries merr përmasa të mëdha shoqërore. Me dhimbjen e vet ajo përpiqet të kundërshtojë botën e egër të mentalitetit e të dhunës mashkullore. Po deri në këtë fragment protesta e saj është e heshtur. Asaj s’i mbetet gjë tjetër veçse të shikojë qiellin e përhimtë. Si stil shkrimi në këtë fragment e në tërë romanin të bie në sy ndërthurja e monologut të personazhit kryesor me gjuhën e drejtpërdrejt të shkrimtarit.

Sa shumë e ndryshuan Hajrinë ato tetëmbëdhjetë vjet të martesës së dytë, habitej edhe ajo vetë. Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli, ishin kryqëzuar tash do rrudha që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thua se në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj. Të gjitha ato kishin marrë tash pamjen e një rrjete marimange në ndonjë qoshe të çardakut. Edhe trupi i saj, dikur i hollë e i gjatë si selvia në mes të malit, ishte kërrusur pak, tash dukej më e vogël. Sytë i ishin zgjeruar e flokët, dikur aqë të zeza e të gjata, sa të gjitha shoqet ia lakmonin, ishin thinjur e rralluar. Megjithatë, Hajria, mu tash, në këto vite pleqërie, e ndjente veten më krenare se kurr ndonjëherë më parë. Sa herë e mendonte jetën e vet, i dukej se ka lindur mu atë

ditë, që u krijua bota dhe se është më e vjetër se të gjithë njerëzit në të. Se kishte parë e përjetuar gjithçka që ndodhi deri tash në botë. E ka përcjellë çdo ngjarje të asaj ane dhe i dukej se vetë kishte marrë pjesë në to, pasi të gjithë ngjarjet e kaluara i mbante mend fare mirë. Sabiti tashmë ishte rritur. Raba kishte vdekur para tri vjetësh. Të gjithë kujtimet e Hajrisë për të kaluarën e vështirë tashmë i mbuloi bukur shumë pluhuri i harresës, sidomos tash kur e shihte të birin burrë, të zotin e çdo pune; tash kur e shihte dhe veten dikund lart, lart mbi të gjithë, thujse prej andej dëshironte t'u thonte të gjithëvet me plot mburrje: "Qe, unë nuk kam qenë fajtorë kurr!..." e ndjente në vete se si i shtohet ajo krenari pse arriti t'u bëjë ballë të gjitha atyre ngjarjeve të mundimshme dhe t'i harrojë deri dikund.

E vetmja brengë, të cilën nuk mund ta shlyente kurrsesi që Aliu. Ai i dhembet e dashuria për të nuk i zvogëlohet fare, edhe pse i urrente nganjëherë ata njerëz. Dashuria prindërore e shtynte të harrojë tërë të kaluarën dhe ta ledhatojë të birin herë pas here, por vetëm me ato kujtime e dëshira, të cilat e ndjente në vete se si i rridhnin dita ditës më tepër. Plot nëntëmbëdhjetë vjet nga ndarja mbusheshin atëherë e asaj i kujtohet vetëm fytyra e tij, ajo fytyrë të cilën e la para aq vjetësh në mesin e atyre maleve të thepisura të Gollakut të largët, të cilën nuk e pa kurr më. "Mos ka vdekë? Kur nuk e ka dëgjue ma as një fjalë për te!" u frigua shpeshherë dhe thellë në vete ndjeu atë dhembje e pikëllim që ia djeg zemrën nënës, të cilën e mundonte dashuria për të birin e humbur. Tash edhe po ta shihte të birin, me siguri nuk do ta njihte më e ëma nuk do ta njihte të birin! Nëna të mos e njohë të birin! I vinte keq edhe asaj dhe çuditej, por s'kishte çka të bënte, pasi e tillë që jeta ndaj saj. Të mos e njohë djalin, për të cilin mendoj gjithmonë, në ditët më të vështira dhe më të lumtura të jetës së vet, të mos e njohë nëna fëmijën, gjirin e së cilës e kishte thithur, atë që e kishte shpëtuar nga vdekja, sepse sikur Hajrija të mos mendonte për të, të mund të mendonte jetën e të birit pa të sajën, atëherë i dukej se jeta e vet ishte e kotë dhe nuk kishte pse të jetojë, prandaj qysh atëherë do të vdiste. Të gjitha këto tash i dukeshin shumë të çuditshme. Sa net i kaloi pa gjumë dhe duke menduar për të! Sa herë ëndërroi e në mëngjes u zemërua në vete pse pranoi të ndahet: pse nuk u kap për derën e shtëpisë sa të mos mundesh askush ta ndajë prej saj. Sa lotë derdhi gjatë atyre nëntëmbëdhjetë vjetëve malli përvëlues, i cili që shumë më i nxehtë se dielli i korrikut. Sa e sa herë e kujtoj atë moment të ndarjes, kur e la të birin për herë të fundit me duar të zgjatura kah ajo dhe vetëm kur e mendonte këtë pamje i kujtohet më së miri fytyra e tij. Iu duk se i biri donte ta luste të mos ndaheshin, por ajo ia ktheu shpinën, kurse kali vazhdonte të ecë rrugës

përpjetë, t'i ndajë e t'i largojë ëmë e bir prej njëri - tjetrit, edhe pse këtë nuk e dëshironin asnjëri.

Aq më tepër e lodhnin edhe mendimet se i biri nuk dinte asgjë për të, për vuajtjet e së ëmës dhe për dashurinë e harruar. Mendonte se i biri do ta përfytyrojë tash vetëm si një grua zemërkeqe, të shëmtuar dhe shtrigë, e pa fije dashurie për të birin, të cilën e urrente pse e kishte lënë atë pa nënë për t'u martuar me tjetërkend. Atij kurr nuk do t'ia tregojë kush romanin e jetës së saj. Atë roman të pashkruar të malësorës, i cili me siguri një ditë do të harrohet, ashtu sikur janë harruar edhe mija e mija të tjerë në këto male të Llapit e të Gollakut, atë roman që e shkruan njerëzit me pashpirtësinë e tyre ndaj njeriut. Romanin për vuajtjet e njeriut nga njeriu. Romanin që zë fill dikund në Gollak, me një vajzë të bukur që ende nuk e kishte shijuar jetën që vazhdon për një grua të pafat dhe që përfundon me ...

Mendimet e tilla e lodhnin Hajrinë tash më tepër se gjithçka. Frika se mos e kishte humbur dashurinë e të birit nuk e lente të qetë, sa herë që i kujtohej jeta e tashme e lumtur. Dëshironte vetëm të dijë se a e urrente ai apo jo dhe se a dëshironte të shohë ndonjëherë të ëmën. Çfarë lehtësimi do të ndjente ajo vetëm sikur ta dinte se i biri e donte, nuk e kishte harruar kurrë dhe se mendonte gjithnjë për të. Por, në atë rmoment në kokë i fluturonte përherë një mendim i ftohtë: "Me më pas dashtë kishte ardhë ndonjiherë. Ai tash asht burrë, kishte mujtë me ardhë!" i thonte vetes dhe pikëllohej përsëri. E sa e sa mendime nuk e lenin të qetë shpeshherë edhe pas kaqë vjetësh; aq shumë pikëllohej nganjëherë sa dilte e shikonte përmallshëm qiellin e përhimtë, andej në drejtim të katundit, ku e la të birin, thua se përpiquej ta shihte atë copë qielli që e mbulonte atë.

### **3.5 Personazhi i Dijes në romanin “Sikur t’isha djalë” – patriarkaliteti ndikim negativ në pozitën e gruas**

Romani “Sikur të isha djalë” ka për protagoniste kryesore një vajzë jetime, të maltretuar vazhdimisht nga njerka që bie viktimë e mentalitetit të vyshkur të viteve të 30-ta. Dijen nuk e ka lejuar i ati patriarkal, Syla, të shkojë në shkollë duke e mbyllur brenda mureve të shtëpisë qysh në fëmijëri. (Sabri Hamiti, Vepra letrare 8, Letërsia Moderne, Faik Konica, Prishtinë 2002, fq. 96. 9)

Ajo do që të martohet me Shpend Rrëfenë, djalë nga Kosova që dashuronte shumë. Ëndrra dhe dëshira e saj nuk do të plotësohet asnjëherë, sepse e martojnë me forcë siç kërkonte i ati, me një tregtar të pasur e të moshuar, të cilin ajo nuk e donte. Ankthi e vuajtjet shpirtërore, bashkë me sëmudjen që i kishte progresuar, e bëjnë Dijen të shkruaj në ditar lutjet e saj për domosdoshmërinë e ndryshimeve sociale në jetën e gruas shqiptare. Shpresat, edhe pse shumë të vogla, i kishte mbështetur vetëm tek ditët pasuese nëse do të ketë njerëz që do të punojnë për t’i çliruar gratë nga fati i tyre i vajtueshëm. Kjo vepër bëhet zëri i mbytur i një femre që kërkon dinjitetin e saj të plotë e stolitur me ëndrra të bukura shpirtërore, psikologji të qartë dhe natyrë tërheqëse gjatë gjithë kohës edhe përkundër sfidave të vazhdueshme. Ajo i kundërvihet krejtësisht mjedisit ku është rritur duke demaskuar gjithë mënyrën e organizimit të jetës familjare e shoqërore shqiptare. Personazhi me emrin Shadije - i njohur më shumë si Dija, përveç përballjes me prapambeturinë e theksuar shoqërore dhe faktin që vendimet për të i merr gjithmonë dikush tjetër, shpërfaq edhe preokupimin e saj për mbulesën. Në njërin prej fragmenteve të librit, të pasqyruar në formë ditari, Dija pyetet se për çfarë në të vërtetë shërben mbulesa, teksa thotë se sikur të ishte fëmijë do ta konceptonte si mbrojtje të rrobave nga pluhuri. Narracioni i Dijes si personazh e autor ka intonacionin lutës të gërshëtuar me anën qortuese e shpesh të zemëruar, të mllefosur për pozitën e vet dhe pozitën e femrës shqiptare në përgjithësi. Gjuha e Dijes gjithmonë është plot plogështi, e plot zhgënjim por e shoqëruar me ndjenja të sinqerta dhe mendime thellësisht njerëzore.

Autori Haki Stërmilli personazhin e Dijes e trajtoi në shumë aspekte duke arritur të depërtojë edhe në ndjenjën religjioze të saj, të bazuara në shumë koncepte liberale lidhur me religjionin e saj. Ajo ishte e bindur se religjioni i mirëfilltë e dërgon përpara shoqërinë. Meqenëse romani është shkruar në formë ditari, në të cilin Dija flet për jetën e vet, është e kuptueshme, që ajo t’i kushtojë më shumë kohë e vend jetës personale, aq më parë kur ky ishte edhe qëllimi kryesor

i saj, përmes shkrimtarit. Dija, ashtu si shumë vajza, vuante nga ligjet e kohës të konsideruara si shumë të egra që nuk pyesin për ndjenjat, për dashurinë e për dinjitetin e askujt. Por në dallim nga ato, ajo nuk do të nënshtrohet, nuk do të mbysë gjithçka që për të është e shenjtë dhe fillon t'i kundërvihet situatave që nuk i pëlqejnë. Kundërvënja ndaj rregullave e ligjeve patriarkale fillon që me dëshirën e saj për të shkuar në shkollë, me përpjekje për të zgjeruar kulturën përmes librave. (Resmije Kryeziu, Personazhi i gruas në letërsinë shqipe mes dy luftërash, Prishtinë 1988, fq.124). Përmes rrëfimit të Dijes shprehet gjithashtu fryma patriarkale e shoqërisë shqiptare, në një anë dhe fryma humane, thellësisht njerëzore e kësaj shoqërie, në anën tjetër, së cilës i kundërvihet injoranca dhe fanatizmi. Fjalët e Dijes vazhdimisht paraqiten me ngarkesë të madhe emocionale të cilën e realizon me fjalë të rëndomta që shpreh mendime e ndjenja personale dhe mendime e ndjenja të autorit dhe të opinionit të gjerë. Në rrethanat jetësore dhe në gjendje shpirtërore e fizike të Dijes ndërhyjnë edhe sëmundja që gjithsesi, është pasojë e kësaj jete, e cila si kategori e së keqës, ndikon në mënyrë vendimtare në përfundimin tragjik të Dijes, por edhe në gjuhën, në stilin lirik të rrëfimit të saj. Dashuria për Shpendin, të cilin e njohu rastësisht te shoqja e saj, kthehet në një tragjedi për të.

Nga njëra anë dashuria e saj bëhet tepër dramatike për shkak të fanatizmit të egër, izolimit brenda mureve të shtëpisë, nga ana tjetër, mungesa e ndonjë shprese se mund të bashkohej ndonjëherë me Shpendin në kushtet kur për gjithçka duhet të vendoste i ati, i cili as që mendon se vajza mund dhe duhet të ketë ndjenjat dhe dëshirat e saj që duhen nderuar. Vendimi i tij për ta martuar Dijen me një burrë të moshuar, sepse është tregtar i pasur, e shkatërron përfundimisht jetën e saj. Gjuha e Dijes është mjaft meditative për moshën që ka, ajo është e vetëdijshme për gjendjen e saj të rëndë dhe për të tjerat vajza myslimane që e kanë fatin si të saj të përshkruar në këtë formë: Femra myslimane, e mbyllun mbrenda katër mureve, asht e mpitë, e dobët dhe e pazhdrivillueme, sepse asht shtypne e mbytë nga zgjedha e randë e një edukate që nuk këshillon enuk porosit tjetër veçse ndalime: mos prek, mos dil, mos fol, mos qesh, mos e mos sa të dojë edukatori.



### 3.5.1 Pozita e gruas shqiptare

Çështjet që parashtrihen në këtë libër lidhen me mendimin për jetën e një gruaje që duhet të jetë pjesëmarrëse në jetën shoqërore. Vepra në fjalë në kohën kur është botuar arriti të trondisë tërë opinionin publik duke bërë jehonë të madhe tek shoqëria shqiptare, pasi heroina e tij tregohet e vendosur në luftën e vet kundër botës së vjetër plot mistere e injorancë, kundër normave të ngurta etiko-morale të saj, pavarësisht se nuk arrin dot dhe s'kishte se si, në mënyrë individuale, të gjente një zgjidhje për një problem aq të rëndësishëm shoqëror.

Romani "Sikur të isha djalë" i bëri jehonë arsimimit e përparimit të gruas shqiptare të viteve të 30- ta, të shtypur dhe të nëpërkëmbur ndër breza duke shpalosur shpesh dhembjen direkte: "Duhet të luftojmë në daçim të rrojmë si njerëz"- shkruan ajo në ditarin e saj.

Kritika letrare ka pohuar disa herë që autori nuk arrin të sjellë një zgjidhje të drejtë me arratisjen e Dijes dhe Shpendit jashtë vendit por, në të vërtetë, ky nuk është një gjykim i saktë sepse autori pikërisht duke sjellë dështimin e kësaj përpjekjeje, i tregon lexuesit se s'mund kurrsesi që kjo të jetë zgjidhja. Ky motiv është ndoshta nga më realistët në roman duke u vlerësuar jo ikja nga e keqja, por përplasja e lufta me të mund të sjellin ndryshime në ligjet dhe opinionin e egër e të prapambetur shoqëror si një përplasje në fytyrë me atë çfarë ndodh në shoqërinë shqiptare. Femra vazhdon të jetë e paragjykuar vetëm për faktin se është femër. Ajo nuk ka të drejtë të bëjë zgjedhjet e saj, nuk ka të drejtë të jetë e lirë, nuk ka të drejtë të jetë e lumtur. Krejt këto vijnë si rezultat i patriarkalizmit duke e konsideruar atë si një objekt shfrytëzues dhe gjithmonë në shërbim të botës mashkullore. Fati i saj i mjerë duket se kishte mbetur në duart e atyre që ndër breza kanë kultivuar fanatizëm social dhe shoqëror si një klithmë gjithmonë aktuale mbi gjendjen e gruas në shoqëri.

Proza e Haki Stërmillit “Sikur të isha djalë”, e konsideruar si një prozë sentimentale, vazhdimisht pasqyron një ndjenjë dhe dhembje të sinqertë duke u përpekur të trajtojë një problem shoqëror të rëndësishëm të realitetit shqiptar.

Elementet e shpirtëzimit të reales përmes bestytive, konsiderohen si një mënyrë pavarësimi nga religjionet që i janë imponuar shqiptarëve dhe si të tilla janë shpalosur shpesh edhe në faqet e romanit që jemi duke trajtuar. Romani përmes vrojtimit qartëson rrjedhën e gjërave duke arritur të diferencoj realitetin nga iluzionet, të pasqyroj fatin e mjerë të atyre femrave fatzeza që bien preh e fanatizmit dhe zakoneve të egra të shoqërisë shqiptare duke pshërëtitur përmes ofshamave të heshturasi: “ E un, sikur të kisha qenë djalë, do të bërtitsha dhe do t'a ngrejsha zanin deri ne kupe te Qiellit që të mundesha me e sigurue mesimin dhe edukimin e femnes ma shume se të mashkullit, sepse femna asht edukatorja e parë e njeriut.” (Haki Stërmilli, Sikur të isha djalë, Botimi I, Tiranë 1936, fq.86.)

Mundimet dhe lutjet e vazhdueshme të Dijes dëshmojnë ndjenjën më sublime të saj karshi shoqërisë maskiliste për të treguar se fatkeqësisht në këtë shoqëri ka femra, që kanë harruar të jenë femra, e që humbasin nën lëpirjen e sumave të pushtetit. Fjalja “Sikur të isha djalë”, padyshim është fraza e ripërsëritur e Dijes e cila synon t’i tregojë botës se çfarë është të jesh një vajzë në një rreth, ambient dhe mentalitet të tillë! Përmes ditarit të Dijes, Stërmilli pasqyron botëkuptimet primitive të familjes patriarkale e cila helmohet kur në të lind një fëmijë e gjinisë femër, apo në rastet kur dashuria, martesë e vajzës pa dëshirën e saj, janë strumbullari i këtij romani. Në strukturën përmbajtësore të romanit, gjejmë të gërshetuar kalvarin e kohës, si fat i qenies shqiptare, i dashurisë shumëngjyrëshe, kontrasti djalë-vajzë, pastaj marrëdhënia e vetë qenies shqiptare me paragjykimet dhe mentalitetin, me pamjet e mjerimit të skajshëm, një problematikë e gjerë që dukshëm e tejkalon kronikën, pothuajse në të gjithë parametrat.

“Sikur të isha djalë” i Haki Stërmillit, pa asnjë dyshim, është tregues strukturor për të vendosur në kohë ndodhinë, ndërkaq forma e shkrimit si ditar disamujor, e ndërthurur me poetikën e rrëfimit dinamik, që i jep tekstit në roman mendohet si një frymëmarrje tjetër. Dija, si personazhi më i realizuar në roman, me një botë të bukur shpirtërore i kundërvihet mjedisit real ku u rrit duke demaskuar mënyrën e organizimit të jetës familjare.

Proza e Stërmillit duke sfiduar realitetet e kohës me meditime e përshkrime të imta të vuajtjeve të dashurisë, po edhe me prezencën e shprehjeve moralizuese përmes deklarimeve retorike vazhdon ta përballë lexuesin me realitetin e kohës.

Përmes personazhit dajë Haxhiu vërehet qartë se ai nuk i pranon botëkuptimet dhe predikimet hipokrite e boshe të hoxhallarëve, por reagon nga pozitat e një bektashiu me pikëpamje liberale dhe të njeriut human lidhur me pozitën e femrës në shoqëri. Me këto pikëpamje, Dajë Haxhiu ka ndikuar në formimin e personalitetit të Dijes, me dëshirën që të krijoj një personazh me pikëpamje përparimtare të fisit të saj, edhe përpjekjet e Shpendit për ta rrëmbyer e për të ikur nga Shqipëria dështojnë. (Resmije Kryeziu, Personazhi i gruas në letërsinë shqipe, mes dy luftërash, Prishtinë 1988, fq.35)

### **3.5.2 Martesa përballë traditës**

Martesa është një moment i mbushur me emocione dhe rituale që e bëjnë unike dhe të veçantë por shumë prej ritualeve, në fakt, vijnë nga besimet dhe traditat. Dija si shumë vajza shqiptare pati fatin të vuaj nga ligjet patriarkale të cilat nuk pyesnin për ndjenjat, dashurinë, dinjitetin e shumëçka tjetër. Babai i Dijes nuk është i vetdijshëm për gabimin e tij në raport me Dijen duke penguar dashurinë me Shpendin dhe duke e fejuar e martuar atë me njeriun që ajo nuk e dashuronte, bile edhe e urrente. Sado që Dija përpiqet, herë në menyrë të vetëdijshme e herë në menyrë të ndërrijshme ta paraqesë të atin si një produkt shoqëror dhe të mos e atakojë atë si një individ, prapë prapë del në shesh karakteri i dobët individual i tij. Babai i Dijes s'është në gjendje t'i kuptojë dredhitë e grackat e të shoqes në dëm të Dijes, sidomos në shprehjen e Dijës kur thotë: "shpifjet që trillon njerka për mue atij i dukeshin si qortimet apo këshillat e Hazreti Hatixhes". (Haki Stërmilli, Sikur të isha djalë, Botimi I, Tiranë 1936, fq.202.)

Raporti i ëndrrës së dashurisë dhe i realiteteve jetësore të Dijes merr fund me një frazë të saj: “Sot nuk jam më virgjeneshë”, që është frazë tragjike sepse thuhet mbasi ajo është shtruar përdhunshëm në shtratin e burrit të zgjedhur po ashtu përdhunshëm. Dija në roman, Shpendit i jep një përshkrim shumë shpirtëror si: tip i çuditshëm dhe i përsosun. Një tip që ka bashkue në vetebukurinë dhe egërsinë, ëmbëlsinë dhe ashpërsinë, butësinë dhe vrazhdësinë, i mbylla sytë që të mos e shof, por nuk mbyllen sytë e mendjes e të zemrës, ajo preku me një fuqi tërheqëse”. (Haki Stërmilli, Sikur të isha djalë, Botimi I, Tiranë 1936, fq.202.)

### **3.5.3. Tendenca për të thyer kodet e traditës**

Për të drejtat e gruas shqiptare në shoqëri ka baza të shëndosha njerëzore të cilat mbështeten fuqishëm në vetëdijen kombëtare. Problemi i pozitës së femrës shqiptare u trajtua si problem social që kërkonte zgjidhje të shpejtë e të drejtë sepse me romanin që jemi duke trajtuar vetëm kishin filluar sinjalet e para të vajzave që mund të thyenin kodet e traditës të cilat tashmë kishin kapërcyer çdo limit kohor. Dija dhe Shpendi ishin dy nga ata të rinj të cilët ishin dakorduar të rebeloheshin kundrejt kodeve dhe traditave të kohës edhe nëse do të flijonin njëri-tjetrin. (Resmije Kryeziu, Personazhi i gruas në letërsinë shqipe, mes dy luftërash, Prishtinë 1988, fq.78.) Përkundër faktit që për babain e Dijes, Shpendi ishte personi i papëlqyer vetëm pse ishte i huaj, kosovar dhe nuk zotëronte profesionin e tregtarit, për Dijen, ky djalosh ishte ndër më të zgjuarit që ajo kishte takuar ndonjëherë dhe shumë ideal në sytë e saj. Provat e vazhdueshme të ikjes së dy të rinjve drejt Italisë, dështimi i tyre para policies, janë fakte të bollshme përtë treguar tendencën drejt thyerjes së kodeve zakonore si më poshtë: Sa e sa breza femnash, që erdhën para nesh, u banë viktimet e këtij zakoni t'egër dhe flija e asaje mendësije që kish për të vetmin qellim të kënaqi kapricjet e një turme injorante, sunduese mbi fatin dhe jetën e atyne femnave të mjera. Kurrkush, deri me sot, s'pat guxim me marrë përsiper një përgjegjesi për me i operue e shërue plagët e kësaj shoqnie që lëngon prej shekujsh. Toka e jonë, për fat të keq, nuk polli një gjeni që t'u epte hov gjallnije turmave të mbetuna nën thundrën e zakoneve primitive për t'u hudhun tej me force; që t'i udhëhiqte për t'u vërvit jashtë kaosit t'errët të fanatizmës”. (Haki Stërmilli, Sikur të isha djalë, Botimi I, Tiranë 1936, fq.212).

Fatkeqësisht, tregimi i dashurisë i Dijes, nuk ndërtohet sipas skemës së ndërhyrjes së personit të tretë, por sipas ndërhyrjes së kodit të dhunshëm të jetës sepse lidhjen dashurore të Dijes me Shpendin nuk e shkatërron personi i tretë i dashur, por personi, burri tregtar, i cili hyn përdhunshëm në këtë raport, vetëm për të përshpejtuar vdekjen e Dijes, pra tragjedinë.

Me martesën e saj të dhunshme, Shpendi nuk është shpëtimi as në ëndrrën dashurore e as në ëndrrën e ikjes. Asaj askush nuk është në gjendje t'i ndihmojë në thyerjen e zakoneve edhe pse kishte mjaft njerëz që e donin dhe që u dhimbsej.

Me sjelljet e babait e të njerkës së Dijes nuk pajtohen të afërmit e tjerë të saj dhe dashamirët e fqinjë të familjes Kërthiza. Të gjithë ata i gjykojnë sjelljet e tyre ndaj Dijes, por për çudi askush nuk provon donjë aksion për t'i ndihmuar asaj .Me sjelljet e Sule Kërthizës e të njerkës së Dijes, nuk pajtohen shumë njerëz nga fisi i Dijes, madje as fqinjët e as dashamirët e tjerë, por për fat të keq, asnjë prej tyre nuk ndërhyr në mënyrë të vendosur për të ndikuar që të ndryshohet qëndrimi i babait e i njerkës ndaj Dijes: “Po t'a kisha pasë në dorëdo t'a grisësja çarçafin dhe nuk do të lejsha femën pa shkollë, pse grueja asht themeli i shoqnis njerzore, pse ajo asht burim i moralit, pse ajo asht nyeja e shenjtë e qenëjes, pse ajo e mbjell farën e dashunis vëllazënore në mes të njerësve. E kur ajo lihet mbas dore vuen e tanë shoqnia njerzore”. (Haki Stërmilli, Sikur të isha djalë, Botimi I, Tiranë 1936, fq.156).

### 3.6 Princesha Argjiro – Heroinë shqiptare

Princesha Argjiro, një grua trime, e zgjuar dhe e vendosur, drejton luftëtarët shqiptarë të kështjellës. Burri i saj, një luftëtar trim, është vrarë për atdheun. Ajo ka një djalë të vogël. I këndon djalit këngë trimërie dhe si gjithë nënat shqiptare dëshiron që i biri i saj të bëhet trim e luftëtar i pamposhtur për mbrojtjen e atdheut. Kalaja e Gjirokastrës dhe legjenda e princeshës Argjiro që e kujtojmë të gjithë përmes Ismail Kadaresë.

Princesha Argjiro është sundimtarja e qytetit të Gjirokastrës gjatë shekullit XIV. Pas vdekjes së burrit, Princesha Argjiro lufton me turqit kur ata e rrethojnë kalanë e Gjirokastrës, mirëpo njeri truprojë e tradhton ndaj ata futen në kala. Për të mos rënë e gjallë në duart e turqve, u hodh nga kulla më e lartë e kalasë bashke me djalin e saj foshnje dhe u copëtua mbi një shkëmb. Mirëpo foshnja sipas legjendës mbeti gjallë.

Princesha me djep në krahë  
U vërvit nga kulla poshtë...  
Dallëndyshet i ke parë  
Kur mësojnë vjeshtës zogjtë?  
Rrugën e parë në jetë  
Me foshnjën bënte princesha.  
Në qiell t'atdheut përpjetë  
Ajo mbeti, e varur peshë.  
Ajo bije e nuk po bije,  
Një shami në hapësirë.  
Pezull mbi shekujt me hije  
Si ëndërr e bardhë ka ngrirë.

Kur megjulla mbulon gjurmët e qytetit të Gjirokastrës, nga lart dallohet vetëm Kalaja e Gjirokastrës. Si një anijë gjigande, ajo shtrihet në gjithë hapësirën e kodrës 336 metra të lartë, mbi të cilën u ndërtua gjatë viteve ‘300. Forca e historisë dhe legjendës së saj e kanë ruajtur ndër vite e, tashmë, ajo mbahet si një nga aktraksionet turistike më të vizituara të Shqipërisë.

E gdhundur në gur, kalaja quhet Argjiro, në nder të legjendës sipas të cilës princesha Argjiro u hodh nga lartësitë e kështjellës për të mos rënë në duart e armikut osman. E kështu, kalaja dëshmon betejën e popullit shqiptar për pavarësi ndër vite, një lufte e gjatë e me shumë pengesa. Këto faza të historisë shqiptare shquhen edhe në ndryshimet që ka parë kjo kala prej kohës së pushtimit osman, në fund të shekullit të 14-të, deri në fillim të viteve 1800 e deri në kohët e mbretit Zog. Sunduesi i Janinës, Ali Pashë Tepelena, mes punimeve rindërtuese la gjurmën e tij në ngritjen e Kullës së Sahatit, në lindje të kalasë. Ndërsa në vitet e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, kështjella u shndërrua në një vendstrehim ku banorët e qytetit mbroheshin nga bombardimet ajrore.

Shkrimtari i mirënjohur shqiptar Ismail Kadare futet në botën e letërsisë për fëmijë me poemën e tij “Princesha Argjiro”. Pikërisht një poezi e shkëputur nga kjo libër u ofrohet nxënësve të klasës së gjashtë si njohje me shkrimtarin i cili emrin e letërsisë shqipe e bën të njohur në shumë vende të botës me përkthimin e veprës së tij letrare në disa gjuhë.

Poema “Princesha Argjiro” e Kadaresë ka një diskurs të theksuar historik sepse vetë ngjarja vendoset brenda sfondit historik të kohës së luftërave turko-shqiptare, gjë që shënon temën qendrore të kësaj poeme. Temë sekondare është personaliteti i një princeshe, një nëne që sfidohet si princeshë e më pas si grua e nënë që rrit një fëmijë e vetme. Kjo poemë e Kadaresë bazohet në legjendën popullore mbi princeshën Argjiro të rrethit të qytetit të Gjirokastrës. “Princesha Argjiro” është një rrëfim për një kohë të shkuar, të largët, për një princeshë trimëreshë që mbrojti nderin e saj duke kërcyer nga kalaja në shkëmbinjtë e ashpër vetëm për të mos rënë në duart e armiqve. Kadare rrëfimin për fëmijë për jetën e princeshës Argjiro e bën duke bashkëbiseduar me Gresën, bijën e tij, të cilës edhe ia ka kushtuar këtë poemë. Ai bën një ndërlidhje Argjiro-Gresë mes dy kohërash, e cila në poemë vjen natyrshëm duke e bërë kështu edhe më të kapshme historinë e Argjiros për fëmijë.

### 3.7 NITA – Përjetimi i metamorfozës (shndërrimi në mashkull i Nitës)

Ngjarja hapet në Brisk, krahinë e Shkodrës ku Nita qe rrëmbyer nga njerëzit e pashës dhe Zefi me tre trima tjerë e shpëtuan. Nga kjo ndodhi, një pjesë e madhe e krahinës vendos te shpërngulet për në Zadar , Dalmaci. Zefi mbeti në Brisk, ndërkohe Nita i dha besën se do ta priste. Kaluan tre vite dhe Nita nuk po martohej ndërkohë që po e kërkonin për nuse djemtë më të mirë. Nita para një situatë të tillë , kërkon ta shpallin mashkull, që të rrinte e qetë. Kërkesa e saj u pranua dhe nga Nita , dhe tanimë do ishte Tani i Prenk Vukës Një ditë në vend po mbaheshin gara vrapimi, në ndërkohe u tregojnë se paska ardhur dikush nga anët tona .

Ishte Zefi, mezi se e kishte gjetur, në ndërkohe Tani ishte i pari , kur mbaroj gara, Zefi shkoi ta takonte djaloshin por atëherë e pa se ishte Nita, të dy e njohën njëri-tjetrin dhe Nites i ra të fikët. U kuptua se ata dy e dashuronin njëri-tjetrin, u mblodh këshilli i pleqëve dhe ata po e shpallin fajtorë Nitën, i kishte gënjyer të gjithë .

U dëgjua krisma e një kobureje , Nita ishte e mbuluar me gjak , Zefi kur e pa armën e vet ia drejtoi vetes por e ndaloi Prenk Vuka dhe i tha tani do jetojmë të dy për Nitën. Në dramën “Nita” autori Josip Rela jep përshkrim të traditës shqiptare, moralit të mbrojtur me shekuj, trimërinë, patundshmërinë ku personazh kryesor është Nita. Nita është një vajzë guximtare. Këtu ajo shfaq shumë virtyte femërore. I dashuri i saj Zefi është shumë trim. Dy veti të cilat karakterizojnë karakterin burror të Zefit janë trimëria dhe dashuria ndaj Nitës. Në aktin e parë flitet për cubat e Agim Beut ,të cilët e grabisin Nitën. Më pas atë e shpëtojnë të rinjtë e fshatit së bashku me Zefin. Por ata detyrohen të largohen nga fshati dhe Zefi qëndron sepse i duhet ta presë babanë e tij. Nita e pret Zefin shumë vite ndërsa në anën tjetër atë e kërkojnë për nuse. Ajo ia kishte dhënë besën Zefit se do e priste dhe se nuk do të martohej me askënd tjetër. Aktin e transformimit të saj në mashkull e përkrahën shumë njerëz. Kjo gjë pritet çuditshëm sepse ajo e fiton garën e vrapimit me meshkuj dhe shpëton jetën e një fëmije. “Nita” është një nga dramat më të njohura shqiptare.



### **3.8 "Emira" e Anton Santorit - drama e parë në gjuhën shqipe.**

Aty trajtohet gjerësisht dukuria shoqërore e cubërisë, që Santori e kishte prekur edhe te novelat e romanet. Ngjarjet zhvillohen në fshatin arbëresh Shën Katerinë të Italisë. Subjekti me pak fjalë është ky: dy vajza fshatare, Emira dhe Kalina, dashurojnë të njëjtin djalë, Mirianin, të cilit i rrah zemra për të parën, po këtë e lakmon edhe bariu i derrave të fshatit, Kallonjeri, njeri pa skrupull, që i vjen rrotull edhe Kalinës. Veprimi zhvillohet në dy linja, përpjekjet e Fumelit për zbulimin e bandave të cubave nga njëra anë, dhe pengesat që i sjell dashurisë së Emirës dhe Mirianit, zilia e Kallonjerit dhe e Kalinës, nga ana tjetër.

Kjo zili e shpie për- para veprimin. Si kallauz i cubave, Kallonjeri i shtyn ata t'i djegin kasollen e t'i mbytin bagëtinë Mirianit, orvatet të rrëmbejë edhe Emirën, po s'ia arrin qëllimit (se vajzën e shpëton vëllai i Mirianit, Albenci). Ky gati sa nuk e vret Kallonjerin, që padit Mirianin me t'anë si bashkëpunëtorë të bandave. Të dy arrestohen dhe janë gati për t'u pushkatuar, kur intrigantin Kallonjer e vrasin vetë cubat për poshtërsitë e tij. Gabimi sqarohet. Miriani me të atin lirohen nga burgu; dhjetë cuba pushkatohen. Drama mbyllet me një fund të lumtur: vendi shpëton prej grabitjeve dhe vrasjeve; Emira dhe Miriani martohen, kështu edhe Kalina me Albencin. Drama frymëzohet nga simpatia e autorit për njerëzit e thjeshtë, nga dhimbja për jetën e vuajtur të fshatarëve. Me realizëm janë pasqyruar rrethanat tipike të jetës së fshatarëve arbëreshë të kohës. Këtu na dalin personazhe të gjalla e të goditura si: Emira, Kalina dhe nënat e tyre.

Në figurën e Emirës kemi tipin e vajzës së thjeshtë të popullit, plot virtyte e cilësi të trashëguara nga mjedisi ku u rrit. Kalina është lozonjare e ziliqare, po në thelb naive e zemërmirë. Një figurë e ndërlikuar është edhe Kallonjeri: djalë i ri, i etur për jetë e dashuri, i pashëm, këngëtar i talentuar, por tek ai është tepër i fortë egoizmi që e shndërron në një hipokrit, intrigant të gatshëm të përdorë çdo rrugë për të arritur qëllimet e veta. Ljipisia dhe Ligjëresha janë figura të goditura plakash fshatare, të cilat kanë të përbashkët mentalitetin konservator. Dramën "Emira" e gjallëron humori i këndshëm. Dialogu është i zhdërvjelltë dhe ka frymë popullore.

### 3.9 Dashuria e Anitës në kohë lufte në romanin *Hasta la Vista*

“Hasta la vista” është romani i parë i autorit Petro Marko dhe më i rëndësishmi për kohën, kur e shkroi, si në rrafshin artistik ashtu dhe në atë tematik.

Rëndësia e tij qëndron veçanërisht, se lajmëroi kthesën në rrjedhat historike të romanit shqiptar. Romani sjell rrëfimin e luftës në Spanjë, ku kryesisht veprojnë personazhe nga mesi i vullnetarëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Në këtë roman rrëfohen betejat e shumta gjatë viteve të kaluara në front, të cilat përshkruhen me një gjuhë të gjallë dhe të papërsëritur. Krahas ngjarjeve për rrjedhat e luftës, rrëfëhet dhe linja e dashurisë ndërmjet luftëtarit shqiptar Gori dhe infermieres spanjolle Anita. Në rrëfimin e parë, shkrimtari e paraqet luftën mes republikanëve që u vijnë në ndihmë vullnetarë nga mbarë bota dhe, monarkistëve të ndihmuar nga fuqitë fashiste evropiane. Në rrethin e të parëve janë dhe vullnetarët shqiptarë që së bashku me të tjerët luftonin fashizmin, që, gjatë luftës në Spanjë (gjysma e dytë e viteve '30) ishte forcuar dhe paralajmëronte Luftën e Dytë Botërore.

Në linjën e dytë, në rrëfimin e dashurisë mes Gorit dhe Anitës, autori arrin efekte nga më të shënuarat në artikullimin artistik. Dashuria mes tyre, në këtë rast, është vendosur në një kontekst ngjarjesh të veçanta, të jashtëzakonshme. Lufta jepet e pranishme kudo e në çdo çast, si shpërthim gjylesh topi apo granate, aty rrotull e nëpër këmbë, e parashikueshme dhe e paparashikueshme njëherazi, është pikërisht ajo që përcakton rrjedhën e ngjarjeve të ditës, të çastit.

E veçanta që Petro Marko solli në temën e dashurisë në romanin “Hasta la vista”, është dashuria midis Gorit dhe Anitës, që është e ngjizur, e ndezur dhe e përmasave të mëdha në ato rrethana lufte.

### 3.10 Figura e femrës sipas Migjenit dhe krahasimi i përdorimit të kësaj figure me Baudelaire

Figura femërore që kur është krijuar universi e deri në kohën tonë ka patur një peshë të madhe. Kjo figurë përbën një motiv tejet të lëvruar në art. Skulptura, piktura, letërsia e kanë himnizuar femrën duke e ngritur përherë e më lart. Të shumtë janë poetët që kanë shkruar për femrën, qoftë si nënë, si grua, si vajzë. Shkëndija u ka ardhur gjithherë nga dashuria.

Pasi ranë në kurthin e dashurisë, Baudelaire dhe Migjeni nuk i shpëtuan dot vuajtjeve, gëzimeve, atmosferës që ajo krijon. Sigurisht që këto ndjesi ata i hodhën në letër. Te të dy poetët, dashuria zë vend të rëndësishëm. Baudelaire njohu dy format plotësuese të dashurisë njerëzore: pasionin sensual për Jeanne Duval dhe dashurinë shpirtërore për Madame Sabatier.

“Bodleri nuk qe ‘i dashuruar’ prej së vërteti, sipas shumicës së studiuesve të tij. Femra i dha atij vetëm ndijime. Kështu, ideali i femrës për Bodlerin u bë ose femra e një tjetër race, ose femra e shëmtuar, ose femra e dobët si skelet, ose femra shumë e moshuar, ose femra me shpirt kriminal, të papastër, djallëzor, ose e përdalura”. (Aurel Plasari, Princ përballë princërve, Tiranë, 1987, f.302)

Migjeni nga ana tjetër, njohu dashurinë sublime, atë më të pastrën, më të shenjtën. Që të dy poetët, ravijëzojnë të gjitha format femërore, femrën prostitutë, murgeshë, lypëse, engjëll. Përmes mendimit alegorik, simboleve, metaforave, ata kërkojnë t’i afrohen universit femëror duke tentuar ta zbulojnë atë. Kemi marrë në analizë disa poezi të dy poetëve ku spikat figura femërore.

Ajo që kemi vërejtur është se si Migjeni dhe Baudelaire kanë disa pika të përbashkëta. Është e lehtë të konstatohet përshkrimi i trupit femëror që ata bëjnë, në poezitë ku si protagoniste është femra. Vërehet një prani e vazhdueshme ngjyrash, formash. Mendimet alegorike sjellin aromën e detit, vallëzimin, larmi figurash që shkojnë drejt kuptimit fillestar të poezive.

Është e tepërt të thuhet se poetët kanë arritur më së miri të krijojnë universin femëror sipas syve dhe mendjes mashkullore. Edhe pse të ndryshëm në lidhje me dashurinë, ata arritën të portretizonin të dashurat, mikeshat e tyre në formën më moderne dhe klasike njëkohësisht. Femra është engjëll dhe djall në të njëjtën kohë. Ajo dashuron dhe urren, fal gëzim por dhe vuajtje dhe të dy ata e dinë mirë këtë. Po e nisim me trajtimin e mënyrës se si Baudelaire dhe Migjeni japin format femërore.

Përshkrimi i trupit femëror

Në poezinë Gjarpri që vallëzon, poeti jep përmes krahasimesh tiparet e vajzës.

“Sa më pëlqen nën ritmin përtacor,

trupi yt që rrëzëllit,

e dashur, si një stof i butë vallëzor,

lëkura të çliron dritë.

Po kur të shoh tek hapin shpejton,

truplëshuara hirshumë

më ngjan një gjarpër që vallëzon

gjer lart sa një bastun.

Kurmi yt thyhet e tendoset prapë,

si një anijezë, pa bujë,

që shket duke zhytur e ngritur lart,

trupin e drunjtë në ujë”. (Sharl Bodler, Lulet e së keqes, Tiranë, 2004, f.44)

Baudelaire duke përmendur trupin e vajzës i përmbledh të tëra. Migjeni kur përshkruan të dashurën fokusohet tek buzët dhe sytë

“Buzët e njoma të saj,

syt e zez e të mdhaj,

me harmoni vijash të bindshme

premtojnë një dashni të hijshme”. ( Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lirs dhe novelat e qytetit të veriut, 2009, f.44)

Baudelaire ndryshe nga Migjeni e përshkruan trupin e së dashurës teksa ajo është në përfundim të aktit seksual. Trupi i saj i ngjet anijes që ngrihet e fundoset mbi dallgë. Ndërsa për Migjenin duket se universi femëror përmbledhet te sytë dhe buzët. Përshkrimin fizik në harmoni me atë shpirtëror, Migjeni ia bën dhe murgeshës te Kënga skandaloze. Murgesha është e zbehtë ashtu si jeta që bën në kuvend. Supet e verdhë si dylli i qirinjve të kishës, buzët e holla e të kuqe e sytë bojë hiri. Sy pa ngjyrë që shohin veç ikona e portrete. Portretizimi është mjaft i goditur.

Përshkrimin e formave trupore të femrës, Baudelaire e ka bërë dhe në plot poezi të tjera. Te Anija e bukur, ravijëzohet koka krenare e saj në harmoni me qafën e gjerë dhe shpatullat e plota. Gjoksi i drejtë, këmbët fisnike, i ndjellin poetit lakmitar dëshirat më të errëta. Ai e sheh veten në përqaftimin e krahëve të fortë. Edhe poezia Kënga e mbasditës është e përshkuar nga fjalët lakmuese e ephndjellëse për trupin e femrës.

“Beli yt, aq i dëshiruar,

ai gjoks dhe ajo shpinë,

bëhesh serioze dhe e mrekulluar

në çdo puthje dhe kafshim,

më shqyen, bukuroshja brune,

me atë të qeshurën mbresëlënëse,

pastaj më vë në zemrën fatlume

syrin e ëmbël si të hënës”.

(Sharl Bodler, Lulet e së keqes, Tiranë, 2004, f.44)

Përshkrimi nuk i mungon as pjesa shpirtërore, e padukshmja, e fshehura nën çarçafë. Baudelaire kujdeset ta mbjellë mirë imazhin e femrës në memorien e lexuesit. Në përshkrimet e tij ai është më pak i turpshëm se Migjeni. Migjeni është delikat, i kujdesshëm dhe diskret. Baudelaire nuk e ka problem fshehtësinë. Migjeni e portretizon të dashurën në shumicën e rasteve në dhomën e tij, ndërsa Baudelaire se ka për gjë t’ia lëvdojë bukurinë dhe mes turmës, gjindjes. Poezia Një kalimtareje ka si protagoniste një vejushë, e tëra në të zeza, çka e bën dhe më tërheqëse figurën e saj.

“E hollë, e gjatë, në të zeza, o ç’dhimbje përrallore,

me këmbët si statujë, e shkathët dhe fisnike, e qetë”. (po aty, f.104)

“Le avete viste qualche volta su quelle panchine solitarie le vedove, le vedove povere? Se siano a lutto o no, è facile riconoscere. Qual è la vedova più triste e più rattristante? Quella che si trascina per mano un bambino con cui non può spartire le sue fantasie? O quella completamente sola?”. (Charles Baudelaire, Opere, Milano, f.402)

Vejusha i ndez instiktet poetit që e vëzhgon nga matanë rrugës. Ai e ndjen vetminë e saj në vështrimin që shkënbejnë. Pavarësisht se përshkrimi i vejushës është i ngjeshur figura e saj zbulohet përmes velit të zi që mban. E gjithë skena zhvillohet në mes të rrugës, mes zallamahisë së njerëzve, të cilët dashur pa dashur bëhen dëshmitarë të flirtit mes vejushës dhe poetit.

Një detaj që nuk na ka shpëtuar pa u vënë re është edhe atmosfera e krijuar te poezitë e tyre ku protagoniste është femra. Ngjyrat, deti, aromat e ndryshme e ndezin imagjinatën e lexuesit. Krahasimet, alegoritë, metaforat, asociacioni, flasin për një lidhje solide brenda logjikës së poezive.

## 1. Ngjyrat

Një tipar që reflekton mendim alegorik, metaforik në poezitë e poetëve janë ngjyrat. Në poezinë me titull Z.B, shpaloset një anë e fshehtë poetike; erotizmi. Poeti i ndihmuar nga simbolika e ngjyrave arrin të pasqyrojë bashkimin me të dashurën. Poezia ka dy ngjyra; të kuqen dhe të kaltrën. E kuqja simbolizon përndezjen, eksitimin, ekstazën, por njëkohësisht dhe perëndimin, mbylljen e aktit seksual. E kaltra është simbol i pafundësisë, infinitit, eskplorimit të kënaqësive në rastin tonë. Një tjetër ngjyrë është dhe e zeza, e errta, që nënkupton thellësi, zhytje drejt honit femëror në kërkim të kënaqësisë maksimale. Gruaja i vjen atij nga zemra e errësirës dhe e fton drejt zbulimit të sferave të panjohura.

“Buzmramja u dridhte ndër afshet e mbramë

të diellit përndimuer

me kuqim e tisa purpuer,

me kaltrina të kullueta në qiellë e në sy tand...”.( Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lirs dhe novelat e qytetit të veriut, 2009, f.42)

Ngjyrën e zezë e hasim te poezia Një natë si dhe te poezia Ndesha ku përmes toneve të errëta, poeti përshkruan ndarjen me gruan.

“O grue, që të ndesha në ditn e fatkobit tem,

kur prirja njellte e syt shikojshin zi”. ( Po aty, f.43)

Migjeni nuk ka lënë pa përdorur edhe të verdhën, të gjelbrën. E verdha i shkon për shtat murgeshës e cila e mbyllur në manastir, nuk e sheh diellin. Dhe sytë e saj janë bojë hiri si vetë jeta e nxirosur prej murgeshe. Vetëm buzët janë të kuqe, sikur duan të tregojnë moshën e re, dëshirat që i flenë kudo e që ajo i ka mbytur me arsye.

E kuqja i ndez zemrën poetit, buzët e kuqe në poezinë Dy buzë janë reflektim i rinisë, i dashurisë, afshit, eksitimit.

Për të treguar dëshirën, eksitimin, ekzaltimin e të riut, Migjeni përdor ngjyrën e kuqe. Buzët e malësores janë të kuqe si qershiat në degë. Ato janë tregues i rinisë, i bukurisë femërore, përndezjes së vajzës teksa ëndërron. “Rrinë malësorja në prak të kasolles dhe në ftyrë të zbetë të sajën skuqen buzët mu si qershiat në degëz”. Në prozën Puthja e cubit, Migjeni e ngjyros ndryshe tablonë idilike. Këtu mbizotëron e gjelbra. Poeti e ndërthur të gjelbrën me kaltërsinë qiellore, si për të treguar pafundësinë e dëshirave rinore. Dila e shtrirë në bar, ëndërron sikur cubi e puth. Bari, (i gjelbër) vendi ku është shtrirë ajo është simbol i shpresës, Dila shpreson se cubi do vijë.

“Asht e flakët dëshira e Dilës në një ditë të shkëlqyeshme pranvere, kur, e shtrime në bar, ndien se si rreh gjaku ndër dej”. (Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lirs dhe novelat e qytetit të veriut, 2009, f.42)

Përmes ngjyrave, Migjeni kërkon të jetësojë, të bëjë të kapshme atmosferën, situatat e krijuara duke i dhënë edhe më shumë tension, suspansë, ndriçim. Tonet, ngjyrat, koloritin e përdor dhe Baudelaire në veprat e tij. E kuqja, e kaltra, e gjelbra, e zeza, e verdha, krijojnë në tablonë e poetit një spektër madhështor, i cili ndriçon dhe krijon konture të forta. Baudelaire luan me tonet duke u dhënë jo vetëm domethënien përkatëse por u shton dhe rrafshin konotativ.

“Si immagini un ampio spazio di natura ove tutto si illumini di verde, di rosso, sfolgorante e liberamente mutevole, e tutte le cose, con diversi colori secondo la propria struttura molecolare, mutate di attimo in attimo allo spostarsi dell’ombra e della luce, agitate dall’interno lavoro dell’energia calorica, si trovino in una vibrazione perenne, la quale fa tremare le linee e porta a fine la legge del movimento eterno e universale. Verdi gli alberi, verde l’erba, verde il muschio; e il verde serpeggia nei tronchi, gli steli acerbi sono verdi; il verde è il fondo della natura perchè il verde si unisce senza difficoltà con tutti gli altri toni”. (Charles Baudelaire, Opere, Milano, f.1017)

Baudelaire e ngjyros lypësen flokëkuqe me të bardhë për të treguar virgjinitetin dhe pastërtinë e saj: flokëkuqe, e bardhë si dëborë e panjollësor. Përmes simbolit të diellit, ai pasqyron gjinjtë e vajzës, në ngjyrë të verdhë, të ndezur si dielli i majit.



“Që nyjet e fustanit të zgjidhen pak nga pak,  
e të zbulojnë për të shpënë në këdo në mëkat,  
ato gjinjtë e tu të butë e të bukur,  
si sy me diellin brenda futur”.

Në poezinë *Flokët* tonet e përdorura janë të errëta.

“Do ta kredh kokën time me dehjen rënë në dashuri,  
në atë oqean të zi, që edhe një tjetër nxë brenda;  
Krifë flokësh blu, pavijon hijesh kudo të hedhura,  
ti kupën qiellore ma bën më të shtrirë, më të paanë;

Mbi skajet e kadifejta të cullufeve të tua të shpërdredhura...”. (Sharl Bodler, *Lulet e së keqes*, Tiranë, 2004, f.41)

E zeza karakterizon seksin e femrës, errësirën brenda honit. Krifa e flokëve me anët e kadifejta qëndron si rojtare e atij oqeani dallgëshumë. Baudelaire nuk heq dorë nga portretizimi i organit femëror me tone të errëta. Te Gjarpri që vallëzon, ai pikturon me të njëjtat ngjyra. Cullufet brune paralajmërojnë thellësinë e pamatë, krifa kaltëroshe e josh poetin për t’u thelluar dhe për të eksploruar qytetin e përjetshëm.

“Mbi kurorën e flokëve të dendur,  
prehet i athti parfum,  
det aromfortë e i kudogjendur,  
valëzim i kaltër e brun”. (po aty, f.56)

Në poezitë e Baudelaire – it shihet dhe një formë tjetër ngjyrosëse, kontrasti. Të vënit përballë dy ngjyra të forta, që krijojnë kontrast të fortë jo vetëm ngjyrash por dhe idesh. Kështu ka ndodhur në poezinë Një e tërë, ku poeti vë përballë të zezën dhe rozën.

“Mes gjithë atyre kurbave plot bukuri,  
që trupin ia kompozojnë magjishëm,  
prej nga krijohet tërë ajo e saja fuqi,  
nga pjesët zi e rozë të bashkuara lirshëm,  
cila është më e ëmbla?”(po aty, f.56)

E zeza, pis si nata e zezë, është honi, errësira, forca diabolike, dominimi. Roza, është ëmbëlsia, qetësia, butësia. Të dyja ndërthuren tek femra duke dhënë herë – herë imazhin e femrës mashkull. Janë dy skajet e segmentit që veprojnë secili për vete. Poetit i pëlqente ashtu siç ishte diabolike dhe engjëllore njëkohësisht.

### 3.9.1 Aroma

Po mundohemi t'i rendisim elementet përbërëse të poezive sipas një rendi logjik. Fillimisht është përshkrimi i trupit femëror, më pas ngjyrat që me simbolikën përkatëse e drejtojnë lexuesin drejt trajektores që ka përshkruar poeti. Pas ngjyrave vijnë aromat, teksa poeti shijon lakuriqësinë e vajzës, janë aromat dehëse që e nxisin të shpejtojë për t'u bërë një me të. Kur kemi folur për futurizmin, një nga tri elementet që sipas Marinetti – it duhej futur në art ishte aroma. Baudelaire dhe Migjeni kanë mundur mjaft mirë ta përçojnë aromën e ëmbël që femra bart. Baudelaire dehet, marroset nga era e gjinjve vajzërorë, nga aroma e athët e peisazhit që ka para syve. Ashtu i trullosur ai komponon për këtë aromë ndjellëse. Poeti e përdor aromën për t'i dhënë hijeshi, për ta aromatizuar edhe më qenien femërore. Në poezinë Parfum ekzotik janë gjinjtë e ndezur të vajzës që e çojnë në ekstazë poetin. Ai ndjehet i eksituar, i dehur dhe teksa frymon gjinjtë e saj ndizet edhe më tepër.

“Kur frymoj aromën e gjinjve të tu të ngjeshur në zjarrmi  
symbyllur, në ngrohtësinë e një nate vjeshte i mpleksur,  
shoh para meje plazhe të lumtur, çmendurisht të feksur,  
të dergjura nën një diell që ndriçon gjithë monotoni.

I prirë prej aromës tënde drejt k'tyre pejsazheve magjikë...”. (Sharl Bodler, Lulet e së keqes, Tiranë, 2004, f.41)

Aroma e gjinjve e transporton poetin në një dimension tjetër. Por ndërsa këtu dehet nga era e tyre në një tjetër poezi ai shkon edhe më tej. Është era e athët e asaj që mund ta quajmë perla e femrës, që meshkujt aq shumë e lakmojnë. Ai nuk ndalet por i këndon dhe kësaj arome natyrore që Natyra, Zoti a kushdo qoftë i ka falur vajzave. Kaçurrelat rreth e qark perlës kanë erën e tyre që ndërthuret me aromën natyrale duke krijuar një pyll aromatik, i cili e tërbon poetin.

“Gjithë ajo botë e largët, e përhumur, gati e vdekur,  
jeton fshehur në thellësitë e tua, o pyll aromatik!” (po aty, f.40)

Baudelaire – in mesa duket e eksiton së tepërmi aroma që vjen nga trupi i së dashurës. Kjo e bën atë të hidhet në sulm si një dem i tërbuar. Ai luan shumë me këtë pjesë dhe pak herë fokusohet në aromën e trupit apo të buzëve.

“Mbi kurorën e flokëve të dendur,

prehet i athti parfum,

det aromfortë e i kudogjendur”. (Sharl Bodler, Lulet e së keqes, 2004, f.44)

Nëse Baudelaire përqëndrohet veçanërisht në pika të caktuara kur është fjala për aromëra, Migjeni është më shumë përgjithësues. Nuk shkon aq larg sa të na servirë ‘pyllin aromatik’ të së dashurës. Edhe kur përmend aromën e gjinjve të gruas te Baladë qytetse e bën për një arsye të fortë. Vetmia në të cilën ndodhet gruaja shtron para poetit çështjen: pse kur ishte e re dhe kur gjinjtë e saj lulëzonin plot aromë ajo dëshirohej prej meshkujve ndërsa tash as sytë s’ia hedhin?

“Dikur,

kur gjit’e saj me kreni

shpërtheshin n’aromë,

kur ish e njomë

atëherë e dashurojshin shumë zotni”. ( Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lira dhe novelat e qytetit të veriut, 2009, f.15)

Dhe sigurisht që vjen përgjigjia: gjinjtë e vajzave kanë aromën e luleve, të trëndafilave, aromën që të fashit dhe të bën të humbësh mendjen. Në poezinë Dy buzë ndjehet aroma dashurore, sensuale me të cilën poeti përshkruan buzët e saj. Ato buzë të kuqe janë simbol i rinisë, i gjakut që vlon. Aroma e tyre i ka mbetur në mendjen poetit pasi ndjesia që i dhanë ato buzë ishte e papërshkrueshme.

Migjeni e shpërngul aromën në natyrë, aty ku është dhe vendi më i përshtatshëm për të. Vajzat janë si pranvera, erëmira, të lulëzuara. Me ardhjen e pranverës, ato lulëzojnë njësoj si kopshtijet, dihasin aromat e luleve të sapoçelura. Atmosfera që krijon Migjeni është një klimë

dlirësie, pastërtie që vetëm pranvera dhe vajzat mund ta krijojnë. Mund të themi se ndryshe nga Migjeni, Baudelaire është më i guximshëm, më pa komplekse, më pak diskret.

### 3.9.2 Vallëzimi

Ajo që bie në sy në disa poezi të Baudelaire – it për femrën është vallëzimi. Edhe në këtë rast duhet të nënvizojmë faktin se nuk është fjala për vallëzimin në kuptimin e dansit, kërcimit. Vallëzimi përdoret për të na çuar në një tjetër drejtim. Nëpërmjet alegorisë, Baudelaire e drejton lexuesin drejt një tjetër kuptimi.

“Po kur të shoh tek hapin shpejton,

truplëshuara hirshumë,

më ngjan një gjarpër që vallëzon

gjer lart sa një bastun”. (Sharl Bodler, Lulet e së keqes, Tiranë, 2004, f.44§)

Gjarpri është femra, trupi i saj, gjarpri është i hollë, i lëvizshëm, përdridhet. Edhe femra në çastin kulmor të aktit seksual dridhet nën pushtetin e kënaqësisë. Vallëzimi i gjarprit është ekuivalent me ekstazën, çastin final. E njëjta situatë është dhe te poezia XXVII, ku vallëzimi përdoret në funksion të vibrimit femëror.

“Me atë veshjen dallgëzuese e dritëlartë,

ti sikur vallëzon, edhe kur ecën qetësisht”. (po aty, f.43)

Ende pa filluar mirë kontakti fizik, ende pa kaluar në ekstazë, poetit i duket sikur e dashura vallëzon, dridhet, vibron. Baudelaire e përdor vallëzimin, të vallëzuarit si maskim pas së cilit fshihet arritja e kënaqësisë seksuale. Çuditërisht, edhe Migjeni jep përmes alegorisë të njëjtën gjë si Baudelaire. Edhe ai e përdor vallëzimin si mbulesë për të fshehur kapërthimin e trupave, mpleksjen dhe ‘afshin e mbramë’.

“Dhe njëmend! At natë vallzuen ndjesit e jona

më një valle dëfryese, pa marrun frymë”. ( Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lira dhe novelat e qytetit të veriut, Tiranë, 2009, f.44)

Tek Migjeni është më i dallueshëm, më i kapshëm, mendimi alegorik. Vallja dëfryese s’është gjë tjetër veçse kënaqësia që sjell akti seksual. Togfjalëshi pa marrun frymë e forcon kuptimin dhe ia bën më të lehtë lexuesit zbërthimin e poezisë. Trupat e të dyve janë në harmoni të plotë, pasi të vallëzosh do të thotë të ndjekësh partnerin, të bëhesh një me të, hapat të rezonojnë. Edhe poeti me të dashurën gjatë bashkimit seksual janë në harmoni perfekte.

Migjeni, në një tjetër poezi e rimerr motivin e valles për t’i dhënë një tjetër dimension. Është fjala për poezinë Baladë qytetse, ku protagonishta e vetmuar, hedh hapat e para të çmendurisë.

“Dy hapa para, dy hapa mbrapa,

dy hapa majtas, dy hapa djathtas.

Jeta e saj asht kjo vall’e çmendun

në rrugat e qytetit tonë”. (Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lira dhe novelat e qytetit të veriut, Tiranë, 2009, f.15)

Vallja e saj e realizuar në rrugët e qytetit në mesnatë është tregues i vetmisë së gruas fatkeqe, i trishtimit dhe i gjendjes mendore të saj. Hapat e gruas rezonojnë me gjendjen mendore dhe shpirtërore. Migjeni e përdor të vallëzuarit edhe në një tjetër përmasë. Në prozën Studenti në shtëpi, Agia e lut të vëllanë t’i mësojë të kërcëjë. Kërcimi këtu merr simbolikën e diçkaje të huaj, të importuar, të sjellë nga jashtë.

– Nush! – bërtet vajza nga dhoma e zjarrmit, – a po më mëson me kërcye?”. ( po aty, f.112)

Migjeni e nxjerr kërcimin në pah për të treguar mentalitetin e ndryshkur shqiptar, sipas së cilit të kërcëje ishte turp, marrë. Pra, Migjeni e ka përdorur në disa forma vallëzimin, ndërkohë që Baudelaire është përqëndruar në një ngjeshje të mendimit poetik duke e thelluar kuptimin. Migjeni

përveç rastit ku afron me Baudelaire – in, në situatat e tjera është më afër kuptimit denotativ të vallëzimit

### 3.9.3 Deti

Deti është i pranishëm si te Baudelaire dhe te Migjeni. Deti simbolizon pafundësinë, thellësinë, infinitin. Ndonëse në poezinë kushtuar Z.B – së, deti nuk përmendet, aty përmendet fjala liman.

“Ku në fund u pasqyronte një dashni e lume

si vegimet e fatbardhsis në limà,

mbi të cilin tërthuer fluturon një pëllumb

dhe gëzime të pamatna gugon pa pra”. ( Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lira dhe novelat e qytetit të veriut, Tiranë, 2009, f.44)

Pas dashurisë poeti dhe e dashura ndjejnë dashurinë e pastër njësoj si ëndërrimi në liman, në një gji deti. Duhet kuptuar që deti nuk është përdorur në kuptimin e drejtëpërdrejtë. Po kështu ka ndodhur dhe me Baudelaire- in. Në poezinë Parfum ekzotik e gjejmë disa herë emrin det, plazh por jo për të treguar kuptimin denotativ.

“Kur frymoj aromën e gjinjve të tu të ngjeshur në zjarrmi

symbyllur, në ngrohtësinë e një nate vjeshte i mpleksur,

shoh para meje plazhe të lumtur, çmendurisht të feksur,

të dergjura nën një diell që ndriçon gjithë monotoni.

I prirë prej aromës tënde drejt k’tyre pejzazheve magjike,

ja tek po shoh një port, grumbuj velash, direkë”. ( Charl Bodler, Lulet e së keqes, Tiranë, 2004, f.40)

Siç dhe kuptohet, poeti është dehur nga aroma femërore, dhe në këtë dehje të ëmbël i dalin para syve plazhe, dete, porte. Këto s'janë gjë tjetër veçse figura të mendimit, me të cilat Baudelaire kërkon të shpalosë trupin, mishin, kënaqësitë e tij. Porti është vendqëndrimi i anijeve, ndërsa në poezi është vendqëndrimi i poetit, i cili gjendet brenda vajzës. Po kështu dhe në poezinë XXVII, deti me valët simbolizon vajzën e cila ecën rrugëve krejt mospërfillëse. Krahasimi është përsëri i goditur. Deti me valë apo dallgë, i qetë apo i tërbuar është tërësisht mospërfillës ndaj njerëzve, qiellit, diellit, shiut.

### 3.9.4 Vjeshta, Errësira

Një tjetër tipar i dukshëm në poezitë e poetëve është dhe errësira, natyra vjeshtore, me ditë të gjata e monotone. Vjeshta dhe nata, janë ekuivalente me melankolinë, trishtimin por dhe me zgjimin e instikteve. Migjeni dhe Baudelaire e kanë futur në shkrimet e tyre këtë element, qoftë kur kanë folur për femrën, qoftë për gjendjen e tyre shpirtërore. Gruaja e Migjenit vjen nga zemra e natës në odën e tij. Terri e ndihmon t'u fshihet syve që e vëzhgojnë.

Situata dramatike e gruas fatkeqe në poezinë Baladë qytetse luhet në mes të natës, në rrugë të madhe. Duket sikur qytetit i vjen ndot nga gruaja (dikur e preferuara e meshkujve). Tani që vitet bashkë me helmin që ka mbushur shpirtin dhe trupin e saj e kanë kthyer në një hije që lëviz, askush se do. Poeti jo më kot e nxjerr gruan – hije të shëtisë natën vonë kur gjithçka ka rënë në gjumë, pasi dhe hijet natën dalin. Ajo endet rrugëve të zbrazura në mesnatë ku vetëm qielli dhe yjet i bëjnë shoqëri.

“Mbramë

qiella dhe hyjt e vramë

një ngjarje të trishtueme panë:

Një jetë e fikun, një jetë e shterun,

një za vorri, një jehonë,

që vallzon natën vonë



nëpër rrugat e qytetit tonë”. ( Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lira dhe novelat e qytetit të veriut, Tiranë, 2009, f.44)

Migjeni pjesën më të madhe të shkrimeve të tij e zhvendos netëve pa hënë. Këtë e bën jo vetëm kur ka si modele femrën por edhe në rastë të veçanta si; Kanga e të burgosunit, Vjeshta në parakalim, Lagja e varfun, etj. Te Kanga e të burgosunit errësira përdoret për të treguar heqjen e lirisë, vuajtjen brenda mureve të qelisë. Sado që jashtë dielli shkëlqen, drita e tij të verbon sytë, në zemrën e të burgosurit ka vetëm terr, trishtim, verbim. Poezia në fjalë është alegorike pasi i burgosuri është vetë poeti. Te Vjeshta në parakalim poeti krijon analogji mes stinës së vjeshtës dhe trishtimit njerëzor, monotonisë që vret.

“Vjeshtë në natyrë dhe vjeshtë ndër ftyra tona.

afshon erë e mekun, lëngon i zyrtë dielli,

lëngon shpirt’i smun ndër krahnore tona...”.(Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lira dhe novelat e qytetit të veriut, Tiranë, 2009, f.44)

Nata me efektet e saj del më gjerë në poezinë Lagja e varfun. Aty jepen të gjitha përmasat e saj, por veçanërisht vetia themelore që është shplodhja. Kur vjen nata njerëzit flenë, pushojnë për të qenë gati të nesërmen. Por nata te Migjeni nuk është vetëm shplodhje nga puna e rëndë, është dhe varfëri, skamje.

“Krahët e zez të një nate pa fund

e varrosën lagjen pranë,

dritë, jetë, gjallsi – askund,

vetëm errësirë e skam.

Pushojnë gjymtyrtë e shkallmueme

në punën e ditës së kalueme,

shërohen trutë e helmueme

në gjumin e natës s’adhurueme”. (Po aty, f.17)

Kështu si Migjeni, edhe Baudelaire e bën pjesë të poezive të tij stinën e vjeshtës dhe errësirën. Edhe ai kur përshkruan tone të trishta që natyra krijon i lidh këto me qytetin. Errësira tek të dy lidhet drejtëpërsëdrejti me qytetin që dremit. E pamë tek Lagja e varfun dhe e konstatojmë dhe te poezia Rrëfim.


## KAPITULLI IV

### ANALIZA E REZULTATEVE

Gjetjet kryesore në këtë hulumtim kanë pasqyruar përqindjen e përfshirjes së shkrimtarëve shqiptarë në temën e figurës së gruas dhe në paraqitjen e kësaj figure. Përmes këtij hulumtimi të realizuar me pyetësorë kemi parë edhe mendimet e mësimdhënëve sa i përket pozitës së gruas në letërsinë shqipe si dhe preferencat e tyre të librave të cilat e përfaqësojnë më së miri këtë fenomen. Rezultatet tona thonë se letërsia shqipe ka qenë e bazuar në ngjarje të vërteta dhe se pozita e gruas është fatkeqe dhe patriarkale duke pasur në sfond gjithmonë shtypjen dhe mosavancimin e gruas.


Hulumtimin e kemi realizuar në dy shkolla fillore të mëdha të komunës së Prishtinës duke i pyetur mësimdhënësit pyetje në lidhje me figurën e gruas në letërsinë shqipe. Ne kemi anketuar 10 mësimdhënës për të parë më mirë se çka mendojnë ata në lidhje me temën e lartpërmendur.

Në pyetjen e parë të parashtruar: *A mendoni se figura e gruas dhe pozita e saj në shoqërinë dhe letërsinë shqiptare ka qenë patriarkale?* Në bazë të rezultateve të gjetura gjatë anketimit të mësimdhënësve me metodën kuantitative, me pyetësorë, rezulton të jetë që: 78% të mësimdhënësve kanë thënë që ka ekzistuar shoqëri dhe letërsi patriarkale në kohërat e mëhershme, kurse të tjerët kanë thënë se nuk ka patriarkalitet.




*Diagrami 1. Pozita e gruas në letërsinë shqiptare*

Në pyetjen e hapur të parashtruar: *Cili libër e përfaqëson më së shumti patriarkalitetin në letërsinë shqipe?* Përgjigja më e shpeshtë ka qenë libri Sikur të isha djalë nga Haki Stërmilli, kurse disa nga përgjigjet kanë qenë Malësorja dhe Emira.



*Diagrami 2. Libri që e përfaqëson më së shumti patriarkalitetin në letërsinë shqipe*

Në pyetjen e parashtruar : *A mendoni se letërsia e sotme ende figurën e gruas e paraqet të nënshtruar?* Në bazë të rezultateve të gjetura gjatë anketimit të mësimdhënësve me metodën kuantitative, me pyetësorë, rezulton të jetë që: 85% nga mësimdhënësit mendojnë se ka ndryshuar stili dhe mënyra e të shkruarit në letërsinë e sotme për figurën e gruas shqiptare.



*Diagrami 3. Dallimet e letërsisë së sotme me letërsinë e vjetër shqiptare*

Në pyetjen e parashtruar: *Rekomandimi i librave për fëmijë nga ana juaj?* Mësimdhënësit janë përgjigjur se librat që u rekomandojnë fëmijëve bazohen në planprogramin që kanë.



*Diagrami 4. Rekomandimi i librave nga mësimdhënësit*

Në pyetjen e hapur se: *A mendoni se duhet të organizohet ndonjë lëvizje feministe, për t'i tejkalar të gjitha vështirësitë e patriarkalitetit?* Shumica e mësimdhënësve mendojnë se duhet të organizohen lëvizje të tilla. Ata thonë se të gjitha shkrimet në letërsinë shqipe janë bazë e ngjarjeve të vërteta.



*Diagrami 5. Lëvizja feministe për tejkalar të patriarkalitetit*

## 5.1 Vërtetimi i hipotezave

Në bazë të realizimit të hulumtimit, pra analizimit të romaneve dhe lektyrave ku përmendet pozita e gruas, me anë të metodës kualitative, duke analizuar librat bazë, duke shfrytëzuar literaturë, si dhe duke realizuar pyetësor me njohës të fushës (mësimdhënës) dhe metodës kuantitative, realizimi i pyetësorëve me mësimdhënës, del se hipotezat e ngritura nga ana jonë, të gjitha janë vërtetuar si të sakta. Hipotezat e ngritura ishin:

H1- Figura e gruas në letërsinë shiptare ka dominuar në kahje negative

H2- Ka dominuar patriarkalitet në figurën e gruas të letërsisë shqiptare

## 5.2 Përfundime dhe Rekomandime

Figura femërore që kur është krijuar universi e deri në kohën tonë ka patur një peshë të madhe. Kjo figurë përbën një motiv tejet të lëvruar në art. Skulptura, piktura, letërsia e kanë himnizuar femrën duke e ngritur përherë e më lart. Të shumtë janë poetët që kanë shkruar për femrën, qoftë si nënë, si grua, si vajzë. Shkëndija u ka ardhur gjithherë nga dashuria. Trajtimi i figurës së gruas ka qenë pikë kyçe e temës sonë. E kemi parë se në shkrimet e letërsisë dhe kryesisht në ato shkrime që mësohen në shkollat fillore figura e gruas përfaqëson dashurinë, mirëpo në anën tjetër kjo figurë është e shkelur dhe pa të drejta njerëzore. Duke u nisur nga Rozafati e cila tregon për flijimin e gruas, vazhdojmë me romanet e tjera Sikur të isha djalë, Emira, Malësorja, figura të cilat janë ndeshur me patriarkalitet dhe shkelje të të drejtave njerëzore. Te Migjeni është e lehtë të konstatohet se përshkrimi i trupit femëror që ai bën, në poezitë ku si protagoniste është femra, vërehet një prani e vazhdueshme ngjyrash, formash. Mendimet alegorike sjellin aromën e detit, vallëzimin, larmi figurash që shkojnë drejt kuptimit fillestar të poezive.

Shumë krijues letrar qoftë në prozë apo poezi portretin e femrës e vejnë në qendër të vëmendjes, ngase me të drejtë konsiderohet se personazhi i femrës ashtu siç i jep kuptim jetës i jep kuptim edhe artit, sepse ajo është edhe kuptim edhe art. Kundërthëniet rreth emancipimit të gruas që dikur ishin të pranishme në shoqëri, tashmë janë tejkaluar. Prapambeturit e asaj kohe ishin si pasojë e ndikimit patriarkal e fisnor e që kishte ndikim edhe sundimi i huaj në vendin tonë. Prandaj problemi i emancipimit të gruas u paraqit si nevojë dhe ishte me rëndësi të studiohet edhe në letërsinë shqipe.

Pyetësozin të cilën e kemi realizuar na ka shërbyer si mostër për t'i testuar hipotezat që i kemi formular qysh në fillim të përpilimit të temës sonë, si dhe na ka shërbyer për t'i pasur disa rekomandime të nevojshme për këtë temë. Ne jemi munduar të bëjmë hulumtim në mënyrë të detajuar duke i përfshirë mësimdhënësit në këtë pjesë të hulumtimit. Fokusi ynë ka qenë hulumtimi me mësimdhënësit duke qenë se ata mund të na japin informacionet e sakta mbi njohuritë e tyre për figurën e gruas në letërsinë shqipe. Studimi që kemi kryer ka qenë i nevojshëm dhe i përshtatshëm për këtë punim.

## **Rekomandimet tona:**

- Të mësohet figura e gruas në letërsinë shqipe dhe të bëhet krahasimi i saj me ditët e sotme;
- Të ndryshohet mendimi në lidhje me pozitën e gruas;
- T'i themi ndal patriarkalitetit pasi në bazë të hulumtimit tonë shumica e ngjarjeve të shënuara në romane kanë qenë të vërteta;
- T'u mësohet nxënësve që gruaja është e barabartë me burrin;
- Të realizohen mësimet dhe grupe feministe duke i përfshirë edhe meshkujt;
- T'u bëhet e qartë nxënësve se dhuna ndaj gruas është dukuri negative dhe ashtu do të jetë përherë.



### 5.3 SHTOJCA

Të nderuar mësimdhënës! Jam, Bukuriqe Totaj , studente e Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës, niveli: Master, drejtimi: Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Aktualisht jam duke realizuar një hulumtim gjatë përgatitjes së temës së diplomës, në kërkim të titullit Master, me temën: “Figura e gruas në letërsinë shqipe”. Ju sigurojmë që këto përgjigje do të përdoren vetëm në aspektin shkencor.

Pyetja 1. *A mendoni se figura e gruas dhe pozita e saj në shoqërinë dhe letërsinë shqiptare ka qenë patriarkale?*

- A) PO
- B) JO

Pyetja 2. *Cili libër e përfaqëson më së shumti patriarkalitetin në letërsinë shqipe?*

---

---

Pyetja 3. *A mendoni se letërsia e sotme ende figurën e gruas e paraqet të nënshtruar?*

- A) PO
- B) JO

Pyetja 4. *Rekomandimi i librave për fëmijë nga ana juaj?*

---

Pyetja 5. *A mendoni se duhet të organizohet ndonjë lëvizje feministe, për t'i tejkuluar të gjitha vështirësitë e patriarkalitetit?*

- A) PO
- B) JO

## Bibliografia

1. Agolli, D. (197). *Jeta në letërsi*. Tiranë.
2. At Bernardin Palaj, At Donat Kurti. (2005). *Eposi i kreshnikëve dhe legjenda*. Plejad.
3. Barthes, R. (2004). *Teoria e Tekstit*. Prishtinë.
4. Baudelaire, C. (A.D.). *Opere*. Milano.
5. Bodler, S. (2004). *Lulet e së keqes*. Tiranë.
6. Dragoti, E. (2004). *Psikologjia Sociale*. Tiranë.
7. Eco, U. (2007). *Si shkruhet një punim diplome*. Dituria.
8. Edwin, J. (1995). *The Albanians: An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present*.
9. Elsie, R. (1997). *Histori e letërsisë shqiptare*. Tiranë: Dukagjini.
10. Feti, S. (2000). *Balada popullore shqiptare*. Prishtinë.
11. Feti, S. (Folkloristikë). 2009.
12. Frangu, D. D. (2003). *Letërsia për fëmijë*. Prishtinë.
13. Grup, A. (2001). *Letërsia bashkëkohore shqiptare 4*. Prishtinë: Libri shkollor.
14. Hamiti, S. (2002). *Letërsia moderne*. Prishtinë.
15. Hamiti, S. (2002). *Vepra 1-8*. Prishtinë.
16. Hamiti, S. (2002). *Vepra VII dhe vepra IX*. Prishtinë.
17. Hamiti, S. (2009). *Albanizma*. Prishtinë: ASHAK.
18. Ibsen, H. (1882). *In An Enemy of the People*.
19. Jefferson Ann, Robey David. (2004). *Teoria letrare moderne*. Tiranë.
20. Kadare, I. (2001). *Princesha Argjiro*. Tiranë: Onufri.
21. Koliqi, E. (a.d.). *Ese të letërsisë shqipe*.
22. Kosovës, A. e. (2009). *Historia e letërsisë shqipe*. Prishtinë.
23. Kryeziu, R. (1988). *Personazhi i gruas në letërsinë shqipe mes dy luftërash*. Prishtinë.

- 24.Kuteli, M. (2012). *Tregime të moçme shqiptare*.
- 25.Mekuli, H. (2000). *Romani Shqiptar*. Prishtinë: Libri shkollor.
- 26.Nasho, J. (2015). *Dashuria nën qerpikë*.
- 27.Nikolla, M. G. (1989). *Vargjet e lira*.
- 28.Nikolla, M. G. (2009). *Novelat e qytetit të veriut*.
- 29.Pasari, A. (1987). *Princ përballë princërve*. Tiranë.
- 30.Pashku, A. (1971). *Oh*. Prishtinë: Rilindja.
- 31.Qeriqi, A. (1994). *Fenomeni i besës në traditën shqiptare*.
- 32.Qosja, R. (1979). *Prej tipologjisë deri te periodizmi*. Prishtinë.
- 33.Rada, J. d. (1980). *Serafina Topia*. Prishtinë: Rilindja.
- 34.Rela, J. (1973). *Nita*.
- 35.Rrahmani, N. (1965). *Malsorja*. Prishtinë: Rilindja.
- 36.Santori, A. (a.d.). *Emira*.
- 37.Shala, D. (1983). *Letërsia popullore*. Prishtinë.
- 38.Stërmilli, H. (1936). *Sikur të isha djalë*.
- 39.Turabiu, A. (1929). *Historia e përgjithshme e bektashinjve*. Tirana.
- 40.Uçi, A. (2013). *Estetika Migjeniane: fryma moderne në letërsinë shqipe*.
- 41.Xoxa, J. (2002). *Lumi i vdekur*. Botimet Enciklopedike.

<https://tradita.org/2020/02/11/gruaja-shqiptare-ne-poezine-refleksive-erotike-te-migjenit/> (çasja për herë të fundit 25.04.2021)